



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
AGJENSIA E SHËRBIMEVE SOCIALE
DREJTORIA E SHËRBIMEVE SOCIALE

№ 2197 Prot

Elbasan më 20⁰⁴/10/2026

RELACION

Mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i Bashkisë për muajin MARS 2026

KËSHILLIT BASHKIAK

Të nderuar Këshilltarë,

Mbështetur në ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” I ndryshuar, ligjin nr. 57/2019 “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”, V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”, si dhe bazuar në kriteret e VKB nr 3 datë 28.01.2026 “Mbi miratimin e kriterëve të dhënies së ndihmës ekonomike nga fondi i Bashkisë”

Propozojmë:

1. Të trajtohen me ndihmë ekonomike nga fondi i të ardhurave të Bashkisë për muajin MARS 2026 gjithsej 78 familje me një fond gjithsej 240.000 lekë.
Këto janë familje shumë të varfëra të cilat nuk kanë mundësi të aplikojnë në sistemin e ndihmës ekonomike pasi për shkaqe të ndryshme sociale, shëndetësore dhe ekonomike, një anëtar madhor nuk është prezent gjatë aplikimit.
Këto janë raste të grave të braktisura nga bashkëshortët e tyre dhe anasjelltas, familje të cilat kanë në përbërje të tyre anëtarë madhorë me probleme të shëndetit mendor të cilët largohen nga banesa pa adresë fikse, familje që kanë në përbërje të tyre anëtarë madhorë me probleme të ndryshme sociale (alkooli, droga etj) të cilët nuk janë në gjendje të paraqiten në ditën e aplikimit të ndihmës ekonomike në sistem.
2. Masa e pagesës për të gjitha familjet përfituese të jetë konform V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike” paragrafi IV pika 11.

Konceptoi: Pergj sektori
Pranoi: Dr Pergjithshem

M.Duka
D.Shuli

Zv/kryetar

Kludia Krasnika



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK ELBASAN

Nr _____ Prot

Elbasan më ____/03/2026

PROJEKT - VENDIM

Nr. _____ datë ____/03/2026

Mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i Bashkisë për muajin MARS 2026

Bazuar në ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, ligjin nr. 57/2019 “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”, V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”, si dhe bazuar në kriteret e VKB nr 3 datë 28.01.2026 “Mbi miratimin e kriterëve të dhënies së ndihmës ekonomike nga fondi i Bashkisë”

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të datës ____/03/2026

VENDOSI

1. Të miratojë dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i të ardhurave të Bashkisë për muajin MARS 2026 për 78 familje me një fond prej 240.000 lekë.
2. Masa e pagesës për të gjitha familjet përfituese të jetë konform V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike” paragrafi IV pika 11.
3. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Shërbimit Social dhe Drejtoria e Financës.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Konceptoi: Përgj sektori
Miratoi: Dr Përgjithshëm
Drejtor Dr Juridike
Drejtor Dr Finance
Konfirmoi: Zv/Kryetar

M.Duka
D.Shuli
A.Hoxha
A.Merkja
K.Krasnika

Sekretar i Këshillit Bashkiak
Elsid Zyma

Kryetari i Këshillit Bashkiak
Lutfi Lala



BASHKIA ELBASAN
DREJTORIA E SHËRBIMEVE SOCIAL
SEKTORI I VLERËSIMIT DHE PAGESAVE TË NDIHMËS EKONOMIKE
DHE AFTËSISË SË KUFIZUAR

INFORMACION KRAHASUES PËR NDIHMËN EKONOMIKE PËR MUAJIN
MARS 2026

I. Ndhimja ekonomike nga fondi i kushtëzuar për muajin Mars 2026

Mars	249 familje fondi	1.163.187
Shkurt	242 familje fondi	1.120.354

Për muajin Mars 2026 kemi 7 familje më shume se muaji paraardhes që propozojmë të trajtohen me ndihmë ekonomike nga fondi I kushtëzuar.

Fondi është 42.833 lekë më shume se muaji paraardhës.

Familjet e larguara nga ndihma ekonomike nga fondi I kushtëzuar janë:

1. Yllka Karaj (larguar jashte shtetit)
2. Zenepe Gjeli (rlarguar jashte shtetit)
3. Lindita Laboti (ka filluar pune)
4. Safet Qemalli (riaplikon në sistem)
5. Rozina Trushi (riaplikon në sistem)
6. Artur Henza (riaplikon në sistem)
7. Kadri Sadiku (nderron jete kryefamiljari)
8. Luljeta isufaj (merr pagese P.A.K)
9. Farije Berisha (nuk terheq leket)
10. Bedri Hanoli (nuk terheq leket)
11. Zamira Sade (nuk terheq leket)
12. Anila Biba (riaplikon ne sistem)
13. Aishe Alla (riaplikon ne sistem)
14. Tauland Kallo (riaplikon ne sistem)
15. Elona Selimi (riaplikon ne sistem)
16. Gulid Lumani (riaplikon ne sistem)
17. Ryzhdije Qosja (larguar jashte shtetit)
18. Lefteri Qosja (larguar jashte shtetit)
19. Kristina Berdufi (ka dale ne pension)

II. Ndhurma ekonomike nga fondi i Bashkisë për muajin Mars 2026

Mars	78 familje	fondi	240.000
Shkurt	76 familje	fondi	233.000

Për muajin Mars 2026 kemi 2 familje më shume se muaji paraardhes që propozojmë të trajtohen me ndihmë ekonomike nga fondi i Bashkisë.

Fondi i shpenzuar është 7.000 lekë më shume se muaji paraardhës.

Familjet e larguara nga ndihma ekonomike nga fondi I Bashkisë janë :

1. Fatmir Shahini (nuk paraqitet)
2. Dritan Kumurija (nuk terheq leket)
3. Mondi Gostima (nuk paraqitet)
4. Skender Preçi (nuk paraqitet)
5. Valentina Meta (aplikon ne sistem)
6. Vjollca Cani (aplikon ne sistem)
7. Mariglen Meçja (aplikon ne sistem)
8. Valbona Muça (aplikon ne sistem)

Konceptoi

Specialiste Ermira Dika



Përgjegjëse Sektori

Miranda Duka





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
AGJENSIA E SHËRBIMEVE SOCIALE
DREJTORIA E SHËRBIMEVE SOCIALE

Nr. Prot 2198

Elbasan më ⁰⁹ 20/03/2026

RELACION

**Mbi dhënien e Ndhmës Ekonomike nga fondi i Kushtëzuar për muajin MARS 2026
KËSHILLIT BASHKIAK**

Të nderuar Këshilltarë,

Bazuar në ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, nenin 21 të ligjit nr. 57/2019 “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”, V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”, si dhe bazuar në kriteret e VKB nr. 4 datë 28.01.2026 “Mbi miratimin e kriterëve të dhënies së ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike”, paraqesim për miratim propozimin e familjeve që do trajtohen nga fondi i kushtëzuar.

- I. Të trajtohen me ndihmë ekonomike nga fondi i Kushtëzuar për muajin MARS 2026, 249 familje me një fond prej 1.163.187 lekë.**

Këto janë familje të varfra të cilat kanë aplikuar në sistemin e ndihmës ekonomike dhe për shkak se nuk kanë marrë pikët e mjaftueshme, nuk janë kualifikuar përfitues të ndihmës ekonomike nga sistemi i pikëzimit.

Këto janë kryesisht familje me një ose dy antarë. Pra këtu kemi familje të cilat janë me një anëtarë, si femrat ose meshkujt në moshë të madhe të pamartuar ose të divorcuar, të cilët kanë ose jo një ose dy fëmijë në ngarkim; personat mbi moshë pune të cilët nuk kanë përfituar pension pleqërie.

Masa e pagesës për të gjitha familjet përfituese të jetë konform V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike” paragrafi IV pika 11.

Konceptoi: Përgj Sektori
Pranoi: Dr Përgjithshëm

M.Duka
D.Shuli

ZV/ KRYETAR

Kludia Krasniqa



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK ELBASAN

Nr _____ Prot

Elbasan më ____/03/ 2026

PROJEKT – VENDIM

Nr. ____ datë ____/03/2026

Mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për muajin MARS 2026

Bazuar në ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar , nenin 21 të ligjit nr. 57/2019 “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë” V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”, si dhe bazuar në kriteret e VKB nr. 4 datë 28.01.2026 “Mbi miratimin e kriterëve të dhënies së ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike” Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të datës ____/03/2026 pasi shqyrtoi materialet e paraqitura nga Drejtoria e Sherbimit Social

VENDOSI

1. Të miratojë dhënien e ndihmës ekonomike nga fondet e kushtëzuara për muajin **MARS 2026** për **249** familje me një fond prej **1.163.187** lekë.
2. Masa e pagesës për të gjitha familjet përfituese të jetë konform V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike” paragrafi IV pika 11.
3. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Shërbimit Social dhe Drejtoria e Financës.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Konceptoi: Përgj sektori

Pranoi : Dr Përgjithshëm

Drejtor Dr Juridike

Drejtor Dr Finance

Konfirmoi: Zv/Kryetar

M.Duka

D.Shuli

A.Hoxha

A.Merkja

K.Krasnika

Sekretar i Këshillit Bashkiak

Elsid Zyma

Kryetar i Këshillit Bashkiak

Lutfi Lala



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
DREJTORIA E INTEGRIMIT EUROPIAN PROJEKTEVE DHE DONATOREVE

Nr. 2214 Prot.

Elbasan, më 20.04.2026

RELACION

**“PËR MIRATIMIN E PJESËMARRJES SË BASHKISË ELBASAN NË PROGRAMIN E MËSIMIT
NËPËRMJET BINJAKËZIMIT COHORT 4 DHE MARRËVESHJES SË BASHKËPUNIMIT ”**

**KËSHILLIT BASHKIAK
ELBASAN**

Të nderuar anëtarë të Këshillit Bashkiak; në mbështetje të ligjit 139/2014 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 26 dhe 29, Në kuadër të zhvillimit të mëtejshëm të bashkëpunimeve me Komisionin Europian në çështjet që lidhen me efikasitetin e energjisë dhe klimës, duke qenë se Shqipëria është një vend që ka një marrëveshje asociative me programin Horizon Europe, ne shprehim gatishmërinë tonë institucionale për të punuar profesionalisht në drejtim të përmbushjes së kriterëve të Misionit Europian për Neutralitetin Klimatik dhe Qytetet e zgjuara ("Misioni i Qyteteve"), me synimin për të arritur neutralitetin e klimës deri në vitin 2030. Institucioni ynë është bërë pjesë e Platformës NetZeroCities, mbështetur nga Programi Horizon, për Marrëveshjen e Gjellbër Evropiane dhe do të punojë për të arritur objektivat e Misionit të Qyteteve në zhvillim të qëndrueshëm.

Nëpërmjet një aplikimi të bërë pranë platformës NetZeroCities, në të cilën jemi pjesë, kemi aplikuar në Programin e Binjakëzimit (Twinning Learning Programme) i cili është një iniciativë e të mësuarit që bashkon qytetet binjake me qytetet që aplikojnë projekte pilot dhe ato misionare. Ky program është ndërtuar mbi shkëmbimin e ndërsjellë dhe përqendrohet në përpjekjet e të fituarit eksperiencë nëpërmjet shkëmbimit. Programi ka një fokus praktik në zbatimin e metodologjive të transformimit sistemik dhe qasjeve inovative në udhëtimin drejt neutralitetit klimatik.



Në këtë program jemi shpallur fitues në cilësinë e qytetit Pilot (që ndan eksperiencën), të binjakëzuar me qytetin e Paredes, Portugali (qyteti i binjakëzuar), sipas aplikimit të Bashkisë Elbasan nëpërmjet Drejtorit të Drejtorisë së Integritimit European, Projekteve dhe Donatorëve dhe konfirmimit nëpërmjet emailit nga drejtuesit e programit (NetZerocities).

Përzgjedhja e qyteteve dhe krijimi i binjakëzimeve bëhet nga përfaqësuesit e programit duke vlerësuar profilet socialo-ekonomike të dy qyteteve.

Aplikimi u orientua në këto shtylla kryesore:

Qasje inovative për zhvillimin ekonomik të gjelbër në Zonën Metalurgjike – Fokus në qëndrueshmëri me teknologji të gjelbra dhe promovimin e praktikave të ekonomisë rrethore.

One-stop shop për rikonstruksionin e ndërtesave të banimit – Përmirësimi i efikasitetit të energjisë dhe ulja e emetimeve.

Zgjidhje për menaxhimin e ujërave të ndotura – Ripërdorimi i ujërave gri për ujitje, ulja e konsumit të ujit, mbështetja e hapësirave të gjelbra dhe forcimi i qëndrueshmërisë së qytetit ndaj ndryshimeve klimatike, duke nxitur rritjen e qëndrueshme urbane.

Programi i Mësimit Nëpërmjet Binjakëzimit është ndërtuar mbi shkëmbimin reciprok. Qytetet binjake do të punojnë drejtpërdrejt me qytetet e Misionit për të mësuar nga përvoja e tyre, me fokus në veprimet klimatike të përshkuara në Kontratat e Qyteteve Klimatike dhe prioritetet e identifikuara në Planet e Veprimit të lidhura. Ky shkëmbim do të na ndihmojë si qytetet binjake të hartojnë aktivitete replikimi të përshtatura për kontekstin e tyre lokal, duke u ofruar qyteteve të Misionit perspektiva të reja dhe inovacione të nxitura lokalisht për të forcuar zbatimin e strategjive të tyre.

I informuar nga aktivitetet e mëparshme të Binjakëzimit të zhvilluara si pjesë e Misionit të Qyteteve, ky program i ri 12-mujor ofron reagime të synuara, partneritete të strukturuar dhe qasje në mjete praktike. Përmes shkëmbimit të njohurive të përshtatura dhe fleksibile, punëtorive dhe vizitave në vend, qytetet mund të përsosin strategjitë e tyre, të përshpejtojnë progresin drejt momenteve kryesore klimatike dhe të forcojnë rolin e tyre udhëheqës në nxitjen e veprimeve urbane për klimën.



Në fund, ky Program Mësimi i Binjakëzimit do të kontribuojë në ndikimin më të gjerë të Misionit të Qyteteve, duke ndërtuar një rrjet dinamik qytetesh që punojnë në mënyrë aktive drejt një të ardhmeje të qëndrueshme dhe neutrale ndaj klimës.

Pas vendosjes së kontaktit të parë mes palëve, dhe miratimit nga ana juaj për vazhdimësinë e këtij programi do të vazhdohet me lidhjen e marrëveshjes midis palëve ku përcaktohen detyrimet dhe të drejtat e gjithësecilit.

Angazhimi në këtë program parashikon disa kosto, si kostot për organizimin e eventit pritës si dhe ato të udhëtimit dhe akomodimit në vizitën e qytetit të binjakëzuar. Programi rimbursion deri në 700 Euro për organizimin e eventit në Elbasan dhe deri në 900 Euro kosto fluturimi dhe akomodimi në Paredes, të cilat do të rimbursohen pas zhvillimit të aktivitetit. Pra, Bashkia Elbasan nuk parashikon shpenzime mbi shumën totale të rimbursimit, por për arsye të procedurave, bashkangjitur materialeve do të gjeni një buxhet të parashikuar me zëra specifike për kostot e organizimit të takimit pritës dhe kostot e udhëtimit për dy persona në total në qytetin Binjak.

Ju lutem gjeni bashkangjitur


- Draft- marrëveshjen e programit;
- Buxhetin Bashkangjitur;

Shprehemi besimplotë në angazhimin tonë institucional me struktura të afta për të menaxhuar me sukses këtë program.

Duke Ju falenderuar,

Konceptoi: P.S.P.100 qytetet: A.Hodaj
D.I.E.P.D: E. Çuni
D.P.B.P.M.S.P: L. Haxhiymeri
D.B.F.A. Merkja
Miratoi: ZV/ Kryetare: K.Krasnika

KRYETARI
GLEDIAN LLATJA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. _____ Prot.

Elbasan, më ____ . ____ . 2026

PROJEKT-VENDIM

Nr. ____, datë __/__/2026




PËR

“PËR MIRATIMIN E PJESËMARRJES SË BASHKISË ELBASAN NË PROGRAMIN E MËSIMIT NËPËRMJET BINJAKËZIMIT COHORT 4 DHE MIRATIMIN E MARËVESHJES SË BINJAKËZIMIT”

Këshilli Bashkiak, në mbledhjen e tij të datës __/__/2026, pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur në mbështetje të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”

VENDOSI

1. Të miratojë pjesëmarrjen e Bashkisë Elbasan në Programin e Mësimit nëpërmjet Binjakëzimit Cohort 4.
2. Të miratojë Marrëveshjen e Programit të Mësimit nëpërmjet Binjakëzimit Elbasan- Paredes dhe partneritetin mes palëve si edhe buxhetin e parashikuar.
3. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Integritimit Evropian, Projekteve dhe Donatorëve dhe Drejtoria e Politikave të Bujqësisë, Pyjeve, Monitorimit dhe Statistikës.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas miratimit në Këshillin Bashkiak.

Konceptoi: Përgj.S.P.100 qytetet A.Hodaj 
D.D.I.E.P.I: E.Çuni
D.P.B.P.M.S.P: L. Haxhiymeri 
Pranoi: D.B.F: A. Merkja
D.Juridike: A. Hoxha
Miratoi: Zv/ Kryetare: K. Krasnika 

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Elsid ZYMA

Kryetar i Këshillit Bashkiak

Lutfi LALA

Plan shpenzimi per Viziten Studimore ne Porto-Paredes Tetor 2026					
Nr. i Aktivitetit	Titulli i Aktivitetit	Njësia	Sasia	Çmimi/ Lek	Totali/ Lek
1	Transport				
1.1	Bilete vajtje-ardhje Tirane- Porto	bilete	2	49500	ALL 99,000.00
1.2	Transport Elbasan - Rinas / Rinas- Elbasan	rruge	2	6000	ALL 12,000.00
1.3	Transport Porto- Paredes/ Paredes- Porto	rruge	2	9000	ALL 18,000.00
2	Akomodim	person	6	9500	ALL 57,000.00
Totali					ALL 186,000.00

Shenim:

Vlera e biletës së avionit është referuar nga platforma skyscanner.net datë 09.04.2026
 Vlera e akomodimit është marrë nga platforma Booking per hotel me 3* sipas percaktimeve zyrtare
 Dieta ditore referuar nga VKM nr. 870 dt. 14.12.2011

Plan shpenzimi per Viziten studimore te stafit te bashkise Paredes Maj 2026					
Nr. i Aktivitetit	Titulli i Aktivitetit	Njësia	Sasia	Çmimi/ Lek	Totali/ Lek
1	Pushim kafeje	Persona	36	360	ALL 12,960.00
2	Dreka	Persona	22	2600	ALL 57,200.00
Totali					ALL 70,160.00

Konceptoi:

P.S.P.100 Q: A. Hodaj

Drejtor D.I.EP.D: E. Çuni

Drejtor P.B.P.M.S.P: L. Haxhiymeri

Drejtor Finance-Buxhet: A. Merfja

Miratoi: Zv/Kryetare: K. Krasnika

KRYETAR
Gledian LLATJA



Programi i Mësimi Nepermjet Binjakëzimit - Marrëveshja

Kohorta 4 Misioni dhe Qytetet Binjake

(Dhjetor 2025 – Dhjetor 2026)

1 Informacion rreth Qytetit të Misionit dhe Qytetit Binjak

Informacion rreth Qytetit të Misionit

#1 përfaqësues pjesëmarrës

Qyteti/Shteti: Bashkia Elbasan

Emri i përfaqësuesit të parë pjesëmarrës të Qytetit të Misionit: Anja Hodaj

Email: anja.hodaj@elbasani.gov.al

Numer Telefoni: +355 698 5551

#2 përfaqësues pjesëmarrës

Qyteti/Shteti: Bashkia Elbasan

Emri i përfaqësuesit të dytë pjesëmarrës të Qytetit të Misionit: Lorena Haxhiymeri

Email: lorena.haxhiymeri@elbasani.gov.al

Numer Telefoni: +355 69 657 1871

Informacion rreth Qytetit të Misionit

#1 përfaqësues pjesëmarrës

Qyteti/shteti: Bashkia Paredes, Portugali

Emri i përfaqësuesit të parë pjesëmarrës të Qytetit Binjak: Paulo Silva

Email: paulosilva@cm-paredes.pt

Numër Telefoni: +351969313782

#2 përfaqësues pjesëmarrës

Emri i përfaqësuesit të dytë pjesëmarrës të Qytetit Binjak: Alexandra Teixeira

Email: alexandra.teixeira@cm-paredes.pt

Numri Telefonit +351967229177

2 Qëllimi i Marrëveshjes

Qëllimi i këtij Programi Mësimor të Binjakëzimit - Marrëveshje është të përcaktojë termat dhe kushtet sipas të cilave përfaqësuesit pjesëmarrës të Misionit dhe Qytetit Binjak angazhohen vullnetarisht për të marrë pjesë në Programin Mësimor të Binjakëzimit (në tekstin e mëtejshëm i referuar si "Programi"), gjatë kohëzgjatjes së Programit: 01/12/2025 – 31/12/2026




Figure 1: Twinning Learning Programme Overview, Cohort 4

Marrëveshja është bërë midis projektit NetZeroCities (për këtë program specifik të përfaqësuar nga Koordinatorin e Programit të Mësimor të Binjakëzimit), Qytetit të Misionit dhe Qytetit të Binjakëzuar të përmendur më sipër.

Duke nënshkruar këtë dokument, të gjitha palët e përfshira bien dakord të bashkohen me Programin e Mësimor të Binjakëzimit dhe zotohen për kushtet e listuara më poshtë.

Marrëveshja hyn në fuqi me nënshkrimin e saj nga të gjitha palët, duke dëshmuar angazhimin e përbashkët ndaj Programit të Mësimor të Binjakëzimit.

3 Angazhimet e 3 Qyteteve

3.1: Përfaqësuesit e Qytetit Mision pajtohen të:

Si Qytet Misioni, ju angazhoheni për elementët e mëposhtëm të Programit të Mësimor të Binjakëzimit:

Dispozita e përgjithshme:

- **Merrni pjesë në shkëmbimin e binjakëzimit:** Përfaqësuesit pjesëmarrës të Qytetit Mision bien dakord të angazhohen aktivisht në Program. Angazhimi në Program përfshin përfundimin e tre (3) Moduleve të të nxënit, siç përshkruhen në Figurën 1., duke marrë pjesë në punëtoritë online dhe në vend, duke përmbushur detyrat dhe arritjet e parashikuara, duke përfshirë pritjen e përfaqësuesve të Qytetit Binjak një herë dhe vizitën në Qytetin Binjak një herë.

- **Ndani burimet e nevojshme (njerëzore dhe buxhetore) për të mbuluar angazhimin në Programin e Mësimin të Binjakëzimit. Kjo përfshin:**
 - Pjesëmarrja në të gjitha punëtoritë dhe ngjarjet e nevojshme (përfshirë ato online) dhe kushtimi i kohës për të zhvilluar udhërrëfyesin e programit dhe planin e përbashkët të veprimit.
 - Organizimi i një vizite në vend me dy përfaqësues të qytetit binjak dhe udhëtimi drejt qytetit binjak për vizitën e tyre në vend:
 - Mbulimi i kostove shtesë, nëse ka, përtej kostove të alokuara të pritjes për një vizitë në Qytetin Binjak prej 700 eurosh për vizitë (p.sh, propozimi i pikave shtesë të rendit të ditës përtej programit dy-ditor).
 - Mbulimi i kostove shtesë, nëse ka, përtej kostove të udhëtimit të alokuara për vizitën në Qytetin Binjak prej 900 eurosh për çdo përfaqësues të Qytetit Mission që udhëton (p.sh., në rastin e një përfaqësuesi shtesë të Qytetit Mission ose ndryshimit në planet e udhëtimit).

Veprime konkrete:

- 1) **Hartimi i Udhërrëfyesit të Programit të Mësimin Nepermjet Binjakëzimit (Twinning Learning Programme):** Pas përfundimit të Modulës I, Qyteti Mission dhe Qyteti Binjak do të paraqesin nevojat ose interesat e tyre konkrete të të nxënit lidhur me klimën, të përcaktuara në Udhërrëfyes. Udhërrëfyesi do të shërbejë si udhëzues tematik për hartimin e të gjitha aktiviteteve të tjera mësimore gjatë Programit të Mësimin të Binjakëzimit. Zgjidhjet për neutralitetin klimatik të përfshira në Udhërrëfyes duhet të jenë sa më konkrete, në mënyrë që të mundësohet një proces mësimor efektiv dhe i synuar mes qyteteve.
- 2) **Reflektimi nga vizitat në terren:** Menjëherë pas përfundimit të secilës vizite në terren që do të zhvillohet gjatë Modulës II, të gjitha qytetet do të bashkëhartojnë një dokument përmbledhës njëfaqësh, i cili do të pasqyrojë mësimet kryesore të nxjerra, vëzhgimet dhe përfundimet, me fokus të veçantë në praktikën e vëzhguara, idetë e shkëmbyera dhe potencialin e tyre për transferim ose përshtatje në kontekstin lokal të secilit qytet. Ky dokument do të shërbejë njëkohësisht si regjistër formal i shkëmbimit dhe si kontribut praktik për procesin e vazhdueshëm të bashkëkrijimit të Planit të Përbashkët të Veprimit.
- 3) **Plani i Përbashkët i Veprimit:** Pas përfundimit të Programit të Mësimin Nepermjet Binjakëzimit, në fund të Modulës III, dhe bazuar në përvojën e përbashkët të zhvilluar me Mission City, të gjitha qytetet priten të bashkëkrijojnë dhe të dorëzojnë një Plan të Përbashkët të Veprimit deri në dhjetor 2026. Ky Plan do të përqendrohet në veprime konkrete që mund të ndërmerren për transferimin e secilës prej praktikave inovative të mësuara nga njëra-tjetra në kontekstin specifik të secilit qytet, me qëllim përmbushjen e angazhimeve për arrijtjen e neutralitetit klimatik.

3.2 Përfaqësuesit e Qytetit Binjak bien dakort të:

Si Qytet Binjak, ju angazhoheni për elementët e mëposhtëm të Programit të Mësimin Nepermjet Binjakëzimit:

Dispozita e përgjithshme::

- Pjesëmarrja në shkëmbimin e Binjakëzimit: Përfaqësuesit e Qytetit Binjak që marrin pjesë bien dakord të angazhohen në mënyrë aktive dhe vullnetare në Program. Angazhimi në programin e përfunduar në përfundimin e tre (3) Mësimin, siç është vërejtur në Figura 1, duke marrë pjesë në punë online dhe prezenciale, duke përfshirë një herë në Qytetin Mission dhe një herë në Qytetin Mission.

- **Ndani burimet e nevojshme (njerëzore dhe buxhetore) për të mbuluar angazhimin në Programin e Mësimin të Binjakëzimit. Kjo përfshin:**
 - Pjesëmarrja në të gjitha punëtoritë dhe ngjarjet e nevojshme dhe kushtimi i kohës për të zhvilluar planin e programit dhe planin e përbashkët të veprimit.
 - Mbulimi i kostove shtesë, nëse ka, përtej kostove të alokuara të pritjes për një vizitë në Qytetin e Misionit prej 700 eurosh për vizitë (p.sh., propozimi i pikave shtesë të rendit të ditës përtej programit dy-ditor)
 - Mbulimi i kostove shtesë, nëse ka, përtej kostove të udhëtimit të alokuara për vizitën në Qytetin e Misionit prej 900 eurosh për çdo përfaqësues të Qytetit Binjak që udhëton (p.sh., në rastin e një përfaqësuesi shtesë të Qytetit Binjak ose ndryshimit në planet e udhëtimit).

Veprime konkrete:

Të përgatisë dhe dorëzojë rezultatet e mëposhtme në lidhje me Programin e Mësimin të Binjakëzimit:

- 1) Udhërrëfyesi i Programit të Mësimin të Binjakëzimit:** Pas përfundimit të Modullit I, Mission dhe Qytetet Binjake do të paraqesin nevojat ose interesat e tyre konkrete të të nxënit në lidhje me klimën, të përcaktuara në Udhërrëfyes. Udhërrëfyesi do të përdoret si një udhëzues tematik për hartimin e të gjitha aktiviteteve të tjera të të nxënit në të gjithë Programin e Mësimin të Binjakëzimit. Zgjidhjet e neutralitetit klimatik të përcaktuara në Udhërrëfyes duhet të jenë sa më konkrete të jetë e mundur për të lejuar një proces efektiv dhe të synuar të të nxënit midis qyteteve.
- 2) Reflektime nga vizitat në vend:** Menjëherë pas secilës prej vizitave që do të zhvillohen gjatë Modullit II, të gjitha qytetet do të zhvillojnë së bashku një dokument njëfaqësh që përmban mësimet, vëzhgimet dhe njohuritë kryesore, duke u përqendruar në praktikën e vëzhguara, idetë e shkëmbyera dhe potencialin e tyre për transferim ose përshtatje në kontekstin lokal të secilit qytet. Dokumenti shërben si një dokument i shkëmbimit dhe një kontribut praktik për bashkë-krijimin e vazhdueshëm të Planit të Përbashkët të Veprimit.
- 3) Plani i Përbashkët i Veprimit.** Me përfundimin e Programit të Mësimin të Binjakëzimit në fund të Modullit III, dhe bazuar në një përvojë të ndarë me Qytetin e Misionit, të gjitha Qytetet pritet të krijojnë dhe të dorëzojnë së bashku një Plan të Përbashkët Veprimi deri në dhjetor 2026, mbi veprimet konkrete që mund të ndërmerren për të transferuar secilën prej praktikave inovative që kanë mësuar nga njëri-tjetri, në kontekstin e qytetit të tyre, me qëllim arritjen e angazhimeve për neutralitet klimatik.

Për të plotësuar informacionin e mësipërm, ne u rekomandojmë përfaqësuesve të Mission dhe Twin City të shqyrtojnë Manualin për qytetet - Programi i Mësimin të Binjakëzimit, Grupi 4, për të kuptuar më mirë aktivitetet e të nxënit nga bashkëmoshatarët në të cilat do të angazhoheni si pjesë e udhëtimit tuaj të Binjakëzimit.

4 Pas përfundimit të Programit të Mësimin të Binjakëzimit

Kohëzgjatja e kësaj marrëveshjeje nuk i pengon palët nënshkruese të vazhdojnë partneritetin midis kolegëve që doli nga Programi i Mësimin të Binjakëzimit NetZeroCities.

Qyteti i Misionit dhe Qyteti Binjak zotohen t'u përmbahen kushteve të Programit të Mësimin të Binjakëzimit si më poshtë. Marrëveshja nuk do të lidhet derisa të dyja palët të kenë nënshkruar dhe datuar këtë formular.

4.1 Formular i miratimit të informuar

Para se të vendosni nëse dëshironi të merrni pjesë apo jo në aktivitetet e lartpërmendura, Konsorciumi NetZeroCities ju fton të lexoni me kujdes deklaratat e mëposhtme. Ju lutemi, mos ngurroni të dergoni email ne twinning@netzerocities.eu. për çdo pyetje, për t'u siguruar që e kuptoni plotësisht qëllimin dhe procedurat e këtyre aktivitetëve, duke përfshirë rreziqet dhe përfitimet.

4.2 Përputhshmëria me rregulloret ligjore dhe etike

Aktivitetet e NetZeroCities sigurojnë pajtueshmëri të plotë me legjislacionin përkatës mbi mbrojtjen e të dhënave dhe standardet etike.

4.3 Pjesëmarrja dhe qëllimi i aktivitetit

Ju ftojme të kontribuoni në këtë projekt sipas përvojës suaj si përfaqësues i qytetit dhe pasi mund të keni përvoja dhe mendime specifike për të ndarë mbi temat kryesore të projektit tonë..

5 Privatësia dhe konfidencialiteti

Rezultatet e Udhërrëfyesit të të Mësuarit dhe Planit të Përbashkët të Veprimit do të publikohen, por ato nuk do të përmbajnë asnjë informacion që mund t'ju identifikojë pa pëlqimin paraprak (shembuj të kësaj mund të përfshijnë citate ose shembuj që i atribuohen individit ose autoritetit vendor).

4.4 Konfidencialiteti

Të gjitha të dhënat e mbledhura do të mbeten konfidenciale. Të dhënat e ofruara nga të anketuarit do të ruhen vetëm në lidhje me qëllimet për të cilat janë marrë dhe aty ku kërkohet, anonimiteti do të garantohet. Emrat do të mbahen konfidencialë brenda ekipit të projektit gjatë analizës së të dhënave, megjithëse citimet e drejtpërdrejta nga intervistat ka shumë të ngjarë të përdoren në raporte. Emri i pjesëmarrësve mund të renditet në listën e pjesëmarrësve, e cila do të përfshihet në raportin përkatës të dorëzueshëm që do t'i dorëzohet Komisionit Evropian dhe i cili do të jetë një dokument i disponueshëm publikisht.

4.5 Siguria e të dhënave

Për të siguruar bashkëpunim efektiv dhe trajtim të sigurt të informacionit të ndjeshëm, projekti përdor portalin bashkëpunues në prapavijë për ruajtjen e të dhënave. Duke përdorur një infrastrukturë të sigurt ruajtjeje, projekti mund të mbrojë konfidencialitetin, integritetin dhe disponueshmërinë e të dhënave, duke nxitur një mjedis të besueshëm për të gjithë palët e interesuara të përfshira. Platforma bashkëpunuese vepron si një qendër qendrore, duke promovuar komunikim efikas dhe ndarjen e njohurive midis qyteteve, duke rritur kështu suksesin e përgjithshëm dhe ndikimin e iniciativës së të mësuarit nga kolegët. Përdoren disa masa dhe procese teknike si enkriptimi, kontrolli i aksesit, autentifikimi, kopjet rezervë të të dhënave, gjurmët e auditimit, firewall-et dhe sistemet e zbulimit të ndërhyrjeve (IDS), transmetimi i sigurt i të dhënave, përditësimet dhe patch-et e rregullta të sigurisë, pajtueshmëria me privatësinë e të dhënave, vlerësimet e cenueshmërisë, etj.

Duke zbatuar këto masa dhe procese teknike, platforma bashkëpunuese mund të krijojë një kornizë të fortë sigurie, duke siguruar qytetet evropiane dhe të gjithë pjesëmarrësit se të dhënat e tyre ruhen dhe trajtohen në një mjedis të sigurt dhe të besueshëm gjatë gjithë programit të të mësuarit nga bashkëmoshatarët

4.6 Ndarja e rezultateve


Gjetjet dhe raportet e projektit pritet të publikohen në raportet publike dhe Portalin NetZeroCities. Të dhënat, për shembull, do të përdoren në shënime politikash, konferenca dhe punëtori dhe si material komunikimi (faqe interneti, media sociale, etj.).

5 Nënshkrimi i marrëveshjes

Për të mbështetur angazhimin në Program të përfaqësuesve pjesëmarrës të dy Qyteteve Binjake, kjo Marrëveshje duhet të nënshkruhet nga një përfaqësues i nivelit të lartë të qytetit, siç është Kreu i Institucionit..

I kam lexuar, kuptuar dhe pranuar termat dhe kushtet e mesiperme.

Ju lutemi, vendosni nënshkrimin tuaj në mënyrë dixhitale ose në një pamje të ekranit/imazh të bashkangjitur, dhe lëreni dokumentin në formatin Word.. Mos printoni dhe nënshkruani manualisht

Udhëheqës/përfaqësues i Qytetit të Misionit	NetZeroCities	Përfaqësues i Qytetit Binjak
<p>KRYETAR</p> <p>GLEDIAN LLATJA</p> <p>Bashkia ELBASAN</p>	 <p>Nupur Prothi</p> <p>Koordinatori i Programit të Mësimin të Binjakëzimit</p>	<p>JOSE ALEXANDRE DA SILVA ALMEIDA</p> <p>Assinado de forma digital por JOSE ALEXANDRE DA SILVA ALMEIDA</p> <p>Dados: 2025.11.21 15:50:08 Z</p> <p>President Municipality of Paredes</p>



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
AGJENCIA E SHËRBIMEVE PUBLIKË RURALE
DREJTORIA E PYJEVE DHE BUJQËSISË

Nr. 2193 Prot.

Elbasan, më 20.04. 2026

RELACION

"PËR MIRATIMIN E THEMELIMIT TE SHOQËRISË TREGTARE "ERE" SH.A, SI PERSON JURIDIK NE PRONËSI TË BASHKISË ELBASAN DHE MIRATIMINE AKTEVE TË THEMELIMIT"

Të nderuar Këshilltar!

Bashkia Elbasan duke patur në fokus të saj zhvillimin e ekonomisë rurale dhe mbështetjen e fermereve si dhe marrë shkas edhe nga kërkesat e disa fermereve nga fshatrat

Krijimi i shoqërisë "ERE" Sh.A. përbën një hap të domosdoshëm dhe strategjik për Bashkinë Elbasan në drejtëm të zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik, menaxhimit efikas të burimeve natyrore dhe fuqizimit të ekonomisë rurale.

Territori i Bashkisë Elbasan karakterizohet nga një potencial i konsiderueshëm në sektorët e bujqësisë, blegtorisë, pylltarisë dhe turizmit natyror. Megjithatë, ky potencial mbetet pjesërisht i pashfrytëzuar për shkak të mungesës së strukturave të organizuara, fragmentimit të tokave bujqësore, mungesës së tregjeve të garantuara dhe kapaciteteve të kufizuara për investim dhe menaxhim. Në këtë kontekst, themelimi i një shoqërie aksionare 100% aksione të Bashkisë krijon mundësinë për një qasje të re dhe më profesionale në zhvillimin ekonomik lokal, duke kaluar nga një rol administrativ në një rol aktiv zhvillimor dhe sipërmarrës.

Baza ligjore e aplikueshme:

- Në mbështetje të ligjit nr.139 /2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar;
- Ligjit nr. 57, datë 30.04.2020 "Për Pyjet", i ndryshuar;
- Ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar, të neneve 26, 28, 32 e 36
- Ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për regjistrimin e biznesit", i ndryshuar,
- Ligji nr.9734, date 14.05.2007 "Për Turizmin",.

Shoqëria "ERE" Sh.A. synon të veprojë si një mekanizëm i integruar që lidh dhe zhvillon sektorët kryesorë të ekonomisë rurale, duke përfshirë menaxhimin e burimeve pyjore, zhvillimin e agroturizmit, mbështetjen e bujqësisë dhe blegtorisë, si dhe promovimin e produkteve lokale. Nëpërmjet këtij organizimi, synohet jo vetëm rritja e të ardhurave për buxhetin vendor, por edhe krijimi i një modeli të qëndrueshëm zhvillimi për zonat rurale.

Një nga dimensionet më të rëndësishme të kësaj nisme është roli që shoqëria do të luajë në mbështetjen dhe fuqizimin e shoqërive bujqësore. Duke qenë një strukturë me kapital publik dhe me besueshmëri institucionale, kjo shoqëri do të mund të bëhet pjesë e këtyre organizimeve si partnere strategjike, duke

kontribuar në garantimin e qëndrueshmërisë së tyre ekonomike dhe funksionale. Në këtë mënyrë, ajo do të shërbejë si një faktor stabiliteti për fermerët, duke i ndihmuar ata të organizohen më mirë, të rrisin kapacitetet prodhuese dhe të sigurojnë dalje në treg për produktet e tyre.

Gjithashtu, përfshirja e SHA në bashkime bujqësore apo struktura të ngjashme krijon mundësi reale për përthithjen e fondeve kombëtare dhe ndërkombëtare, duke rritur aksesin në programe mbështetëse për zhvillimin rural, investimet në bujqësi, përpunimin e produkteve dhe turizmin. Kjo do të ndikojë drejtpërdrejt në rritjen e konkurrueshmërisë së sektorit dhe në përmirësimin e mirëqenies së komuniteteve rurale.

Në të njëjtën kohë, shoqëria do të mundësojë një menaxhim më të strukturuar dhe efikas të pasurive natyrore, veçanërisht të fondit pyjor, duke siguruar jo vetëm shfrytëzim ekonomik, por edhe mbrojtje dhe përmirësim të tyre në përputhje me legjislacionin në fuqi, përfshirë **Ligji nr. 57/2020**.

Pra themelimi i shoqërisë "ERE" Sh.A. nuk është thjesht një akt formal organizativ, por një instrument i rëndësishëm zhvillimi, që synon të transformojë mënyrën se si Bashkia Elbasan ndërvepron me ekonominë lokale. Nëpërmjet saj krijohet një platformë e qëndrueshme për zhvillim afatgjatë, për rritjen e të ardhurave, për krijimin e vendeve të punës dhe për garantimin e vazhdueshmërisë së aktiviteteve bujqësore, blegtorale dhe agroturistike në territor.

Bazuar në Aktin e Themelimit, për krijimin e shoqërisë tregtare "ERE" sh.a, kërkohet miratimi i fondit në vlerën 5,000,000 lekë, për krijimin e kapitalit themeltar të shoqërisë. Për këtë qëllim, propozojmë transferimin e fondit 5,000,000 lekë, në buxhetin e vitit 2026, nga DPKS, funksioni 08230, artikulli 602 "Festat e Njësive Administrative", në funksionin 04220, artikulli 604, institucioni Bashkia.

Përfundime:

Në përfundim, sa më sipër, vlerësojmë se krijimi i një strukture të dedikuar dhe profesionale është i domosdoshëm për shfrytëzimin efikas të potencialeve bujqësore, blegtorale, pyjore dhe turistike të territorit të Bashkisë Elbasan, si dhe për garantimin e zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik dhe mbështetjen e bashkimeve bujqësore.

Për këto arsye, **kërkojmë dhe propozojmë miratimin e krijimit të shoqërisë tregtare "ERE" Sh.A., si një instrument i rëndësishëm zhvillimi dhe menaxhimi modern i ekonomisë rurale në territorin e Bashkisë Elbasan.**

KRYETARI
Gledian Llatja

NË MUNGESË DHE ME URDHËR
ZV/KRYETARI
Asim Sula

Konceptoi: I. Baho
Pranoi: L. Haxhiymeri
Miratoi: Sh. Çullhaj
D.Finances: Alketa Merkja





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN

Nr. _____, Prot

Elbasan më, _____. _____. 2026

AKT THEMELIMI
Për krijimin e shoqërisë tregtare

"ERE"sh.a.

Sot, me datën ___/___/2026, unë, aksioneri themelues, si person juridik publik, si më poshtë:

Bashkia Elbasan, person juridik publik, njësi bazë e vetëqeverisjes vendore brenda territorit të Qarkut Elbasan, e krijuar sipas ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" (i ndryshuar), me seli në Qytetin e Elbasanit, me adresë: **Rruga "Qemal Stafa", Elbasan**, përfaqësuar nga Kryetari i Bashkisë Elbasan, z. **Gledian Llatja**.

Në mbështetje të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, të ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar, si dhe të ligjit nr. 9723 datë 03.5.2007 "Për regjistrimin e biznesit", i ndryshuar.

Vendosi si më poshtë vijon:

NENI 1

Forma juridike

Shoqëria themelohet në formën e një shoqërie aksionare (Sh.A.) me ofertë private, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe me ligjin nr. 9901/2008.

NENI 2

Qëllimi i krijimit të shoqërisë

Qëllimi i shoqërisë është ushtrimi i veprimtarisë ekonomike me karakter fitimprurës në funksion të zhvillimit rural, bujqësor, blegtoral, pyjor dhe agroturistik në territorin e Bashkisë Elbasan.

NENI 3

Emri, logója dhe vula e shoqërisë

1. Shoqëria do të dalë në qarkullimin juridiko-civil me emrin **"ERE"sh.a.**
2. Shoqëria do të ketë logon dhe vulën e saj. Logoja do të përmbajë fjalë nga emri i shoqërisë.

NENI 4 Objekti i veprimtarisë

Shoqëria tregtare "ERE" sh.a. ka për objekt ushtrimin e veprimtarive ekonomike në funksion të zhvillimit rural, mjedisor dhe agroturistik, si më poshtë:

1. Shoqëria ushtron veprimtarinë e saj në përputhje me legjislacionin në fuqi, duke respektuar parimet e transparencës, konkurrencës dhe mbrojtjes së interesit publik.
2. Zhvillimi, administrimi dhe promovimi i agroturizmit, përfshirë ngritjen dhe menaxhimin e bujtinave, fermave turistike, aktiviteteve rekreative dhe edukative në zonat rurale.
3. Prodhimi, grumbullimi, përpunimi, ambalazhimi dhe tregtimi i produkteve bujqësore dhe blegtorale, përfshirë produkte bio dhe tradicionale.
4. Tregtimi i produkteve bujqësore të freskëta dhe të përpunuara brenda vendit dhe eksportimi i tyre.
5. Krijimi ose marrja me qira e pikave të grumbullimit për tregtimin e fruta-perimeve të freskëta dhe të përpunuara.
6. Grumbullimi, përpunimi, ambalazhimi dhe tregtimi i qumështit dhe nënprodukteve të tij (djathë, gjalpë, gjizë etj).
7. Shfrytëzimi, menaxhimi dhe përmirësimi i fondit pyjor; prerja dhe përpunimi i lëndës drusore; grumbullimi dhe tregtimi i produkteve pyjore drusore dhe jodrusore; shërbime pyjore dhe mjedisore; pyllëzim dhe ripyllëzim; prodhim dhe tregtim biomase; transport dhe tregtim i produkteve pyjore; si dhe çdo aktivitet tjetër në përputhje me legjislacionin në fuqi në fushën e pyjeve dhe mjedisit.
8. Ofrimi i shërbimeve mjedisore, përfshirë:
 - mirëmbajtjen dhe rehabilitimin e sipërfaqeve pyjore dhe rurale
 - menaxhimin e mbetjeve bio, riciklimin dhe kompostimin e tyre
 - projekte për mbrojtjen e biodiversitetit dhe mjedisit
9. Zhvillimi dhe zbatimi i projekteve në fushën rurale, bujqësore, pyjore dhe agroturistike, të financuara nga fonde publike, private apo donatorë.
10. Ndërtimi dhe mirëmbajtja e infrastrukturës funksionale, që lidhet drejtpërdrejt me aktivitetin e shoqërisë (agroturizëm, ferma, objekte shërbimi rural), në përputhje me legjislacionin në fuqi.
11. Bashkëpunimi me subjekte publike dhe private, vendase dhe të huaja, për zhvillimin e projekteve dhe investimeve në fushat e mësipërme.
12. Administrimi, dhënia, marrja me qira dhe në përdorim të pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme, në funksion të realizimit të objektit të shoqërisë.
13. Aplikimi dhe përfitimi i fondeve, granteve dhe subvencioneve, si dhe pjesëmarrja në programe kombëtare dhe ndërkombëtare zhvillimi.
14. Çdo veprimtari tjetër ekonomike të ligjshme, që lidhet drejtpërdrejt ose tërthorazi me realizimin e objektit të mësipërm si zhvillimi dhe operimi i aktiviteteve të turizmit dhe rekreacionit, përfshirë struktura shërbimi si bar-kafe, restorante, kënde lojërash dhe hapësira argëtimi.
15. Të krijojë Sh.A., Sh.p.k., SH.B.B. apo shoqëri tregtare të ndryshme, me subjekte dhe grupim subjektesh, si dhe të marrë pjesë si anëtare bashkëthemeluese në Shoqëritë e Bashkëpunimit Bujqësor, apo shoqëri të tjera tregtare.

NENI 5

Selia e shoqërisë dhe afati i veprimtarisë

1. Selia e shoqërisë tregtare " ERE"sh.a. do të jetë në qytetin e Elbasanit, me adresë : Rruga "Qemal Stafa", Elbasan.
2. Shoqëria zhvillon aktivitetin e saj për një afat kohor të pacaktuar, duke filluar nga dita e regjistrimit të saj në regjistrin tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

NENI 6

Kapitali themeltar

1. Kapitali themeltar i shoqërisë është 5.000.000 lekë (pesë milion) lekë, i cili përbëhet nga 100 aksione të zakonshme, me një vlerë nominale prej 50.000 (pesëdhjetë mijë) lekë secili.
2. Bashkia Elbasan, zotëron 100% të vlerës së kapitalit të shoqërisë të barabartë me 100 aksione, me vlerë të përgjithshme prej 50.000 (pesëdhjetë e mijë) lekë, për çdo aksion të shlyer për tërësinë e vlerës nominale.

NENI 7

Përbërja e kapitalit të shoqërisë

1. Kapitali themeltar i shoqërisë do të jetë i përbërë nga kontributi në para dhe/ose në natyrë i aksionarit themelues të kësaj shoqërie.
2. Kontributi në para do të jetë i përbërë nga shuma prej 5.000.000 leke (pesë milion) lekë, që është një vlerë më e lartë sesa edhe vlera minimale e kapitalit themeltar për shoqërinë, me ofertë privat.

NENI 8

Organet drejtuese

Shoqëria organizohet sipas sistemit me dy nivele:

Asambleja e Përgjithshme e Aksionerëve - organi më i lartë vendimmarrës;

- Këshilli Mbikëqyrës - organ i mbikëqyrjes; përbëhet nga ;
 - Z. _____
 - Z. _____
 - Z. _____
- Administratori Z. _____ - organ ekzekutiv dhe administrativ i shoqërisë.
- Eksperti/ët kontabel i/të autorizuar.

Shoqëria është e organizuar në sistemin e administrimit me dy nivele, administrator drejton shoqërinë dhe merr vendime për mënyrën e vënies në zbatim të politikave tregtare, ndërsa Këshilli Mbikëqyrës, në cilësinë e organit mbikëqyrës, këqyr vënien në zbatim të këtyre politikave dhe përputhjen e tyre me ligjin dhe statutin.

Kohëzgjatja e mandatit të anetarëve të Këshillit Mbikëqyrës do të jetë 3 (tre) vjet. Ata kanë të drejtë të rizgjidhen.

NENI 9

Administratori

1. Administratori i parë i shoqërisë tregtare "ERE"sh.a. është Z. _____
2. Shoqëria përfaqësohet para çdo organi administrativ, gjyqësor, enti publik apo privat dhe në marrëdhënie më të tretët nga Administratori i saj, i cili i ushtron këto të drejta në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi.

NENI 10

Eksperti kontabel

1. Asambleja e Përgjithshme ka të drejtën për të caktuar një ose disa eksperte kontabel të zgjedhur nga listat e Institutit të Eksperteve Kontabel të Autorizuar.
2. Në caktimin e eksperteve mbahen parasysh përjashtimet dhe papajtueshmëritë e përcaktuara në rregullat e posacme. Ekspertet kontabel caktohen për një kohë që i përgjigjet një ushtrimi financiar. Ata janë të ricaktueshëm.
3. Shpërblimi i ekspertëve kontabel të autorizuar caktohet nga Asambleja e Përgjithshme dhe përballohet nga shoqëria. Shoqëria tregtare "Eko Rural Elbasan"sh.a., do të ketë 1 (një) ekspert kontabel.

NENI 11

Autorizimi procedurat e themelimit

Aksionarët themelues autorizojnë Kryetarin e Bashkisë për të aplikuar për regjistrimin fillestar të shoqërisë aksionare "ERE"sh.a. Rregjistrimi bëhet tek Qendra kombëtare e Biznesit.

NENI 12

Organizimi dhe funksionimi i shoqërisë, ngritja e degëve apo filialeve të saj, do të bëhet në përputhje me dispozitat e ligjit përkatës dhe statutit.

NENI 13

Aksionari/Aksionarët themelues mund të vendosin, me vullnetin e tyre, për pjesëmarrjen në shoqëri të tjera dhe mund të krijojnë çdo lloj aktiviteti tjetër privat, përveçse atij që mund të jetë konkures me atë të shoqërisë tregtare "ERE"sh.a.

NENI 14

Mosmarrëveshjet për themelimin e shoqërisë zgjidhen me mirëkuptim nga aksionarët themelues dhe kur kjo nuk arrihet, ato zgjidhen nga gjykata kompetente sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Akti i themelimit redaktohet në 4 (katër) kopje origjinale, të njëjta në gjuhën shqipe.

AKSIONARI THEMELUES
BASHKIA ELBASAN
PËRFAQËSUAR NGA
KRYETARI
Gledian LLATJA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK**

PROJEKT-VENDIM

Nr. _____ datë _____ 2026

**"PËR MIRATIMIN E THEMELIT TE SHOQËRISË TREGTARE "ERE" SH.A, SI
PERSON JURIDIK NE PRONËSI TË BASHKISË ELBASAN DHE MIRATIMINE AKTEVE
TË THEMELIT"**

Këshilli bashkiak pasi shqyrtoj materialin e paraqitur nga administrata e bashkisë në lidhje me Miratimin e themelimit te shoqërisë tregtare "ERE" sh.a, si person juridik ne pronësi të bashkisë Elbasan dhe miratimin e akteve të themelimit, në mbështetje të bazës ligjore të mëposhtëme:

- Në mbështetje të ligjit nr.139 /2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar;
- Ligjit nr. 57, datë 30.04.2020 "Për Pyjet", i ndryshuar;
- Ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar, të neneve 26, 28, 32 e 36
- Ligji nr.9723, datë 3.5.2007 "Për regjistrimin e biznesit", i ndryshuar,
- Ligji nr.9734.date 14.05.2007 "Për Turizmin",.

VENDOSI

1. Krijimin e shoqërisë tregtare "ERE" sha, në formën e shoqërisë tregtare aksionare, me objekt objekt ushtrimin e veprimtarive ekonomike në funksion të zhvillimit rural, mjedisor dhe agroturistik
2. Miratimin e aktit të themelimit dhe statutit te shoqërisë " ERE "sha.a si dhe të ngarkojë Kryetarin e Bashkisë ose personin e autorizuar prej tij, që të nënshkruaj aktet e themelimit të kësaj shoqërie tregtare.
3. Shoqëria " ERE " sh.a, themelohet, organizohet dhe funksionon si shoqëri me aksione, në përputhje me parashikimet e ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", të ndryshuar.
4. Kapitali fillestar për krijimin e shoqërisë " ERE " sha do të jetë 5.000.000 (Pesë milion) lekë.
5. Bashkia Elbasan është ortak i vetem themelues, i cili zotëron 100% te kapitalit themeltar te shoqërisë "ERE ".
6. Shoqëria " ERE " sha, te ketë selinë qendrore në adresën," Rruga Qemal Stafa (Godina e Bashkisë).
7. Shoqëria "ERE "sha, të zhvillojë aktivitetin e saj për një afatkohor të pacaktuar.
8. Bashkia Elbasan, brenda 15 (pesëmbëdhjete) ditëve nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi, ndjek procedurat e nevojshme për regjistrimin e shoqërisë " ERE "sha.
9. Shoqëria " ERE " sha, në funksion të ushtrimit të veprimtarisë së saj, ka të drejtë të shqyrtojë dhe të vlerësojë mundësinë e bashkëpunimit me shoqëritë e tjera tregtare dhe të hyje në mardhenie kontraktuale me persona te tretë.
10. Të autorizojë kryetarin e Bashkisë ose personin e deleguar prej tij që të përfaqësojë Bashkinë Elbasan, në cilësinë e aksionarit të vetëm përkryerjen e të gjitha veprimtarive të nevojshme për përgatitjen dhe nënshkrimin të akteve të themelimit të shoqërisë së re dhe regjistrimin e saj në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

11. Bashkia Elbasan i siguron shoqerise "ERE " sha, nga inventari i saj i pronave të paluajjtshme apo ambiente të tjera të kontraktuara ndaj të tretëve, mjediset e nevojshme për fillimin e ushtrimit të veprimtarisë sipas objektit të saj.
12. Bashkëngjitur relacioni shpjegues.
13. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
14. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes publike (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore").

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Elsid Zyma

KRYETAR

Lutfi Lala

Konceptoi: I. Baho

Pranoi: L. Haxhiymeri

Miratoi: Sh. Çullhaj

Nenkryetar: A. Sula

D. Juridike: A. Hoxha

Miratuar me _____ vota

Vota Pro _____

Vota Kundër _____

Vota Abstenim _____

Zbardhur me datë ____ / ____ 2026



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN

DREJTORIA E PËRGJITHËSHME E PYJEVE, KULLOTAVE, MJEDISIT,
BUJQËSISË DHE MBROJTJES CIVILE
DREJTORIA E POLITIKAVE TË PYJEVE, BUJQËSISË, MJEDISIT, STATISTIKËS DHE
PERFORMANCËS

Nr. 2249 Prot.

Elbasan, më 21.09. 2026

RELACION

“PËR MIRATIMIN E PLANIT TË PARANDALIMIT DHE SHUARJES SË ZJARREVE NË FONDIN PYJOR KOMBËTAR, BASHKIA ELBASAN”

Të ndieruar Këshilltar!

Administrimi i fondit pyjor dhe kulloror në pronësi të bashkisë Elbasan, bazohet kryesisht në ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 27 pika 5 i këtij ligji ku shprehimisht thuhet: *Funksionet e bashkive në fushën e bujqësisë, zhvillimit rural, pyjeve dhe kullotave publike, natyrës dhe biodiversitetit.*

Baza Ligjore:

- Ligji nr. 15/2014 “Për ndarjen administrative-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”;
- Ligji nr. 57, datë 30.4.2020 “Për Pyjet”;
- Ligji nr. 9693, datë 19.3.2007 “Për fondin kulloror” i ndryshuar;
- Ligji nr. 10431, datë 09.06. 2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 152, datë 21.12. 2015 “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi”;
- VKM 1080, datë 22.12.2010 “Mbi rregullat për parandalimin dhe shuarjen e zjarreve në pyje dhe kullota”.

• **Definicion:**

“Zjarr” është dukuria e djegies, e shoqëruar me nxehtësi të lartë, tym dhe dritë në formë flakësh përcëlluese.

“Zjarr normal” është zjarri që shkakton dëm, për përballimin e të cilit janë të mjaftueshme forcat operacionale, mjetet dhe pajisjet e stacionit zjarrfikës të bashkisë.

“Zjarr masiv” është zjarri që zhvillohet apo tenton të zhvillohet në sipërfaqe e volume të konsiderueshme, për përballimin e të cilit, përveç forcave operacionale, mjeteve e pajisjeve që zotëron shërbimi zjarrfikës i një stacioni, kërkohet edhe pjesëmarrja për ndihmë nga stacionet zjarrfikëse të bashkive të tjera.

“Zjarr me përmasa të mëdha” është zjarri që zhvillohet në sipërfaqe e volume të mëdha, për përballimin e të cilit, përveç forcave operacionale, mjeteve e pajisjeve që zotëron shërbimi zjarrfikës, kërkohet edhe pjesëmarrja, për ndihmë, e forcave e mjeteve të shërbimeve apo strukturave të tjera operuese.

“Organizim i ndërhyrjes në shuarjen e zjarrit dhe shpëtimit” është tërësia e masave tekniko- organizative të nevojshme, për organizimin e forcave të ndryshme, mjeteve, pajisjeve zjarrfikëse, metodave e taktikave, të cilat përdoren për ndërhyrjen në shuarjen e zjarrit, evakuimin dhe shpëtimin e jetës së

njerëzve, kafshëve dhe pronës. Një zjarr në pyll është një zjarr me sensibilitet të zgjeruar në zonat pyjore të mbuluara me shkurre, bimësi pyjore apo pyje të lartë duke përfshirë edhe strukturat e vendosura brenda pyjeve. Objektivi kryesor që duhet të ndiqet është kufizimi i dëmit duke ulur sipërfaqet e mbuluara nga zjarri duke vepruar në drejtim të parandalimit dhe luftës aktive kundër zjarrit në pyje. Parandalimi i zjarreve në pyje duhet të bazohet në njohjen e motiveve dhe të finalizohet duke vepruar në luftën aktive për parandalimin e tyre.

Mbrojtja e pyjeve nga zjarret duhet të bazohet në:

- Integrimin e veprimeve midis parandalimit dhe zhdukjes së zjarrit.
- Organizimin e shërbimeve të integruara zjarrfikëse me strukturat e tjera të angazhuara në mbrojtjen e pyjeve.

Ligji bazë mbi të cilin kryhet administrimi i fondit pyjor është ligji nr.57/2020 "Për pyjet", i ndryshuar si dhe aktet nënligjore në zbatim të tij. Administrimi dhe menaxhimi i fondit pyjor publik ka kalur në pronësi të Bashkisë Elbasan me VKM nr.433 dt 08.06.2016 "Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave publike, sipas listës së inventareve, dhe aktualisht në administrim të MM e të ish komunave/bashkive", i ndryshuar. Në sistemin natyror pyjet dhe kullotat zënë një sipërfaqe të konsiderueshme me vlera ekonomike, mjedisore, rekreative, turistike. Pyjet shpërndahen në të gjithë territorin e bashkisë, por veçanërisht në zonën malore, ku gjenden pyjet e lartë dhe me vlera të larta peizazhike.

Bashkia Elbasan në kuadër të ushtrimit të funksioneve të saj, ka nën administrim pyjet dhe kullotat bashkiake, kjo sipas mënyrës së përcaktuar me ligj, sipërfaqet e pyjeve dhe kullotave të kaluara nën administrim dhe juridiksion të saj janë gjithsej **54979.01 ha**.

Pjesë e këtij administrimi të qëndrueshëm të fondit pyjor/kullosor është edhe mbrojtja e pyjeve nga zjarri. Për këtë arsye në zbatim të dispozitave ligjore, Bashkia Elbasan nëpërmjet Drejtorisë së Administrimit të Pyjeve dhe Kullotave ka hartuar Planin e Masave për parandalimin dhe shuarjen e zjarreve në fondin pyjor/kullosor për vitin 2026.

Qëllimi i Planit të Masave për parandalimin dhe shuarjen e zjarreve në fondin pyjor/kullosor është ruajtja dhe mbrojtja e trashëgimisë pyjore nga zjarret, siç përcaktohet në Ligjin nr.57/2020 "Për pyjet" neni 1 ku specifikisht shprehet "*Mbrojtja e pyjeve si pasuri me rëndësi të veçantë, për vlerat e mëdha dhe të pazëvendësueshme në mbrojtjen e klimës, të tokës, ruajtjen dhe përmirësimin e potencialeve prodhuese, të ekuilibrave të mjedisit natyror, biodiversitetit, burimeve gjenetike dhe regjimit hidrik, si detyrim me interes kombëtar dhe ndërkombëtar*".

Për të ndjekur këtë qëllim, strategjia e Planit është zhvilluar në tre komponentë të konsoliduar dhe të përhapur edhe në nivel kombëtar dhe Evropian: **parashikimi (referuar rasteve të viteve të meparëshme të zjarreve), parandalimi dhe lufta aktive kundër zjarreve në pyje**, së bashku me atë të trajnimit dhe edukimit mjedisor. Lista e bimëve sipas zonave vertikale bimore bazuar në studime të ndryshme është shumë e gjatë e ndarë në zona si mëposhtë:

- Zona e makjes (shkurret) shtrihet në lartësinë 400-500 m lartësi mbi nivelin e detit. Prej drurëve dhe shkurreve gjethembajtëse, më të përhapura të kësaj zone, janë: ilqja, dëllinja e kuqe, shqopa, ulliri, mareja, dafina etj. Prej drurëve dhe shkurreve gjetherënëse mund të veçojmë: shega, shkoza e zezë, murrizi një bërthamësh, manaferra, driza, krekëza, thanukla, vidhi i bardhë, amorfha shkurre, gjineshtra, frashër uji, frashëri i bardhë, plepi i bardhë, plepi i zi, shelgu i zi, shelgu i kuq, vërri i zi, fiku etj.

- Zona e dushkut shtrihet në lartësitë 300-700 metra mbi nivelin e detit. Llojet më të përhapura të gjinisë Quercus të kësaj zone: bulgëri, qarri, shparthi, etj. Drurë dhe shkurre të tjerë të kësaj zone janë: panja rrapi, panja mali, panjë, gështenjë, vodhëviçëza, vodha, mëllezë, blini, lajthia, murrizi pesëbërthamësh, dëllinja e zezë etj.
- Zona e ahut ndodhet në lartësitë 600-1700 m mbi nivelin e detit dhe së bashku me nënzonën e pishës shkon deri 1900 m. Në këtë zonë gjenden lloje të drurëve si ahu, panja e malit, si dhe shkurret: borbulli i padhëmbëzuar, mjedra, boronica etj. Nga halorët më shumë gjenden: rrobulli, pisha e zezë e më pak të tjerat.
- Zona e kullotave alpine shtrihet 1800-1900 m mbi nivelin e detit. Disa gjini dhe lloje bimore më të përhapura të kësaj zone janë: trëndafili i egër, samina, shelgu zvarritës, flokësa, bishtpelëza, luluza italiane, këlerie, gentiana pranverore, lulekëmbana, klokëza etj.

Pavarësisht masave të ndërmarra përgjatë viteve, ende theksi nga të gjithë aktorët adresohet tek mbrojtja e pyjeve, duke u përmbledhur në një kërkesë të thjeshtë:

“Pyllin vetëm mbroje, sepse rritet vetë!”

Plani i masave parashikon masat që do të merren nga Bashkia Elbasan në bashkëpunim me institucionet e tjera bashkëpunuese për parashikimin, parandalimin, luftimin aktiv dhe trajnimin e personelit dhe jo vetëm.

Ky Plan masash është vjetor dhe është realizuar bazuar në një analizë të thelluar të territorit.

Janë analizuar zonat e territorit dhe periudhat e vitit në të cilat ka më shumë të ngjarë të ndodhë një zjarr i cili është thelbësor për të parandaluar fillimin ose përhapjen e tij.

Për të parandaluar zjarret, të cilat, siç dihet, varen pothuajse ekskluzivisht nga shkaqet njerëzore, nevojitet vetëdijësim që synon respektimin e pyllit, shmangien e qëndrimeve ose veprimeve të rrezikshme dhe për këtë arsye bashkëpunimin aktiv në mbrojtjen e trashëgimisë pyjore.

• Zjarret në pyje:

Sipërfaqet e përshkuara/djegura nga zjarri.

Arsyet e rënies së zjarreve janë nga më të ndryshmet, por në bazë të përvojave dhe njohurive të deritanishme në 90 % të rasteve të shfaqjes së këtyre zjarreve si shkak paraqitet njeriu (*direkt ose indirekt*) evidenca e rënies së zjarreve për vitin 2025 e vërteton më së miri këtë fakt. Rrufeja apo vetëndezja e pyjeve kap vetëm 5-10% të rasteve. Renja e zjarreve në pyje/kullota ku shkaktar është njeriu ndodh nga pakujdesia, padituria, piromania si sëmundje apo qëllim i pastër. Zjarret e shkaktuara nga pakujdesia apo padituria, përfshijnë kryesisht zjarret e shkaktuara nga njerëzit që punojnë në pyje apo kullota të cilët kryejnë punime operacionale në këto zona. Këto zjarre ndodhin zakonisht në pranverën e herëshme kur vegjetacioni baror nga viti i kaluar është i thatë dhe vegjetacioni i ri akoma nuk ka filluar. Këtu si shkaktarë të zjarreve janë mbledhësit e frutave pyjore, bimëve medicinale, gjetarët, fremerët apo edhe turistët. Zjarret e qëllimshme bëhen me qëllim që të zgjerojnë tokën e punëshme apo kullotat, ku njeriu ndez zjarrin pa llogaritur pasojat. Motivet e këtyre zjarreve janë nga më të ndryshmet, ato mund të jenë edhe për përfitim ekonomik, për përfitim dru të lirë për dru zjarri apo ndërtim, për të mbuluar prerjet ilegale etj. Klasifikimi i zjarreve në pyje/kullota. Sipas llojeve të zjarreve në pyje mund ti specifikojmë në:

- Zjarr nëntokësor ose nësipërfaqësor
- Zjarr sipërfaqësor ose pranë nëntokës
- Zjarr në kurorat e drurëve
- Zjarr i përgjithshëm ose i kombinuar

Më i përhapur tek ne janë tre rastet e fundit: Zjarri sipërfaqësor është zjarri në të cilin djegia aktive zhvillohet në sipërfaqe të tokës dhe digjet përgjithësisht bimësi pranë tokës në sipërfaqe si bar, filiza,

shkurre etj. Në vartësi të kushteve dhe pranisë së erës flakët e zjarrit mund të arrijnë deri në 2m. Në rajonet e rafshëta djegia intensive zakonisht ndjek buzët e zjarrit, ndërsa në zonat kodrinore-malore ajo zhvillohet në ballin e zjarrit. Shpejtësia e përhapjes së këtij zjarri (pa erë te fortë) mund të arrijë deri në 2.5 km/h.

Faktoret që ndikojnë në rritjen e rrezikut për shfaqjen dhe zhvillimin e zjarreve ne pyje.

Më të rëndësishmit janë:

-Lloji i bimësisë

-Topografia

-Stina vjetore

-Karakteristikat klimaterike

-Komunikacioni

• Masat për parandalimin e zjarreve në pyje/kullota

Të gjitha masat që merren për parandalimin e zjarreve sipas kohës kur ndërmeren dhe me çfarë qëllimi, ndahen në:

a. Masa preventive

b. Masa përgatitore

c. Masa direkte

a. Masat preventive

Janë masa mbrojtje kundër zjarreve që merren vazhdimisht gjatë gjithë vitit. Kjo për shkak se njeriu është shkaktar i tyre në 99% të rasteve edhe këto masa janë të përqëndruara plotësisht ndaj njeriut.

Qëllimi final është të parandalohet shkaktimi i zjarreve dhe të zvogëlohet numri i këtyre zjarreve. Në këtë kuadër këto masa janë. Masa ligjore, mbrojtja e pyjeve/kullotave rregullohet me ligje dhe akte nënligjore ku mbrojtja e tyre është përgjegjësi e të gjithëve por edhe e pronarëve (bashkisë apo subjekteve private) si edhe subjekteve që i menaxhojnë ato. Masat edukative, këto janë masa të cilat në vetvete përfshijnë edukimin e njerëzve dhe përdoren për të gjithë grupmoshat, mgjs më të përdorurat janë për të rinjtë deri në 18 vjet. Mënyrat janë nga më të ndryshmet që nga mësimet në librat shkollorë, leksione të hapura për mbrojtjen e pyjeve nga zjarret, përdorimi i revistave, fletpalosjeve, internetit tv etj. Masa informative- propagandistike, qëllimi i tyre është për të paralajmëruar dhe informuar njerëzit për rreziqet nga paraqitja e zjarreve në pyje si edhe për të informuar se si duhet të silllemi gjatë qëndrimit në pyll. Kjo masë kombinohet edhe me atë edukative.

b. Masa përgatitore

Duke patur parasysh që masat preventive nuk e zgjidhin plotësisht problemin e mbrojtjes së pyjeve nga zjarret, është e domosdoshme marrja e masave përgatitore. Këto masa kanë një natyrë të përherëshme gjatë gjithë vitit dhe përfshihen: Zbulimi në kohë i zjarrit, transferimi i informacionit mbi zjarrin, organizimi i zjarrfiksave dhe vullnetarëve, ndërtimi i hendeqeve kundra zjarrit, përgatitja e planit operativ vjetor për mbrojtjen e pyjeve nga zjarret. Zbulimi në kohë i zjarrit është i një rëndësie të madhe për lokalizimin dhe fikjen shpejt të tij. Zonat tona malore kanë një dukshmëri të dobët, me qëllim që zjarri të mund të zbulohet në kohë organizohet shërbimi i monitorimit në terren nga vëzhguesit kundra-zjarr / vrojtuesve kryesisht me patrullim nga toka në periudhën më të rrezikuar të vitit (*Sipas VKM nr.1080/2010 për 5 muaj*). E rëndësishme për këtë fazë është që nëpërmjet institucioneve qëndrore (*ministri/agjensi etj*) dhe jo vetëm të kryhet monitorimi nga ajri , mbikqyrje automatike apo elektronike si edhe vëzhgimi satelitor. Masa keto të cilat do të mundësojnë zbulimin dhe monitorimin e këtyre zjarreve. Transferimi i informacionit mbi zjarrin i kryer në mënyrë të shpejtë dhe ka efektin e dëshiruar. Dhënia e këtij informacioni bëhet nëpërmjet telefonit apo edhe sinjalet e tjera si flamuj etj.

Qytetarët të cilët zbulojnë zjarre në pyje/kullota duhet të njoftojnë në nr. e tel 128 Shërbimin Zjarrfikës.

Një organizim më i mirë në mënyrën e transferimit të informacionit do të jetë nëpërmjet radiove- lidhese apo ndërtimit të rrjetit të marrje-dhënie nëpërmjet pajisjeve vëzhguese në të gjithë territorin e mbuluar me pyje. Organizimi i zjarrfiksive dhe vullnetarëve deri tek vatra e zjarrit është shumë e rëndësishme për këtë arsye duhet njoftuar menjëherë me zbulimin e zjarrit. Transporti i organizuar i zjarrfiksive dhe pajisjeve mënyra e organizimit të tyre dhe vullnetarëve krijon premisa për menaxhim të mira të situatës së zjarrit. Ndërtimi i hendeqeve kundra zjarrit shërben si si një pozicion mbrojtës për zjarrfikësit por edhe vullnetarët për këtë arsye hendeqet ekzistuese në pyje duhet të jenë gjatë gjithë kohës të pastruar nga materiali djegës. Hapja e hendeqeve dhe dimensionimi i tyre (gjerësia) është e ndryshme në vartësi nga lartësia e pemëve, pjerësia e terrenit etj. Psh nëse drurët janë rreth 20m , gjerësia e hendekut do të jetë minimuni 40cm. Përgatitja e planit operativ vjetor për mbrojtjen e pyjeve nga zjarret

c. Masa direkte

Pavarësisht nga masat më të mira preventive të marra, zjarret përsëri ndodhin. Për këtë arsye nevojiten masat direkte. Këto janë masa të cilat ndërmerren gjatë kohëzgjatjes së zjarrit dhe synojnë lokalizimin dhe shuarjen e tij. Për të lokalizuar apo shuar një zjarr është e nevojshme të largohet një nga elementet nga i ashtuquajti *trekëndësh i Osborn-it*, përkatësisht materiali djegës, burimi i nxehtësisë apo oksigjeni. Sipas asaj se cili material ose mjet përdoret për këtë qëllim, metodat e shuarjes ndahen në: Shuarje e zjarrit me tokë, metoda më e vjetër e përdorur për këtë qëllim, ku materiali i tokës përdoret si izolator, pra largon elementin oksigjen nga materiali djegës. Toka gjithashtu vepron si një izolant i nxehtësisë, përkatësisht energjia termike për djegien e drurit. Shuarje e zjarrit me ujë, edhe kjo një ndër metodat tradicionale në shuarjen e zjarreve. Veprimi i ujit në procesin e shuarjes është i shumëfishtë. Luftimi i zjarrit me zjarr, megjithëse duket si koniuzë, kjo metodë është efektive por mbart në vetvete rrezik dhe kërkon persona të trajnuar dhe me përvojë. Në vartësi të taktikës për lokalizimin dhe shuarjen e zjarrit, në një distancë të caktuar nga zjarri ndizet një "zjarr i kontrolluar" (*që mund të lëvizë në drejtim të kundërt ose të njëjtë me drejtimin e lëvizjes së zjarrit*) i cili djeg materialin para frontit të zjarrit, kur zjarri arrin në atë sipërfaqe, nuk ka çfarë të djegë dhe zjarri shuhet. Shuarje e zjarrit nga ajri nëpërmjet aeroplanëve është përdorur për herë të parë në vitin 1930. Në përgjithësi kjo është një metodë uji ose kimikatesh, por për shkak të specifikës është e vcurar si metodë e vecante. Është metodë mjaft e shpejtë dhe efikase sidomos për rastet e terrreneve malore. Shuarja e zjarrit me kimikate, në këtë rast përdoren kimikate të ndryshme. Kjo metodë alternohet me atë të ujit sepse në përgjithësi këto kimikate shpërbëhen nëpërmjet ujit. Llogaritet se 70% e ujit që përdoret në shuarjen e zjarreve lërrehet pa efektivitet, për këtë arsye ujit i shtohen kimikate të ndryshme të cilat përmirësojnë efektin e shuarjes së zjarrit. Shuarje e zjarrit me eksploziv, përdoret kryesisht si metodë ndihmëse. Kryesisht për të rrezuar pemë, gjermim kanalesh, krijim pengesash etj. Në rastet e shpërthimeve krijohet "re e pluhurit" e cila ul përqindjen e oksigjenit në ajër rrjedhimisht zjarri ul intensitetinose shuhet plotësisht. Veprimet kryesore gjatë zbulimit të zjarrit në pyje/kullota. Detyrë qytetare e çdo individi, në rast se zbulon zjarr në pyll/kullotë, është që të njoftojë sa më shpejt të jetë e mundur institucionet përgjegjëse. Nga shpejtësia e informimit, saktësia dhe përmajtja varet suksesi i aksionit të shuarjes së zjarrit. Hapat që duhet të ndërmerren janë: **Telefononi nr 128 pa pagesë i Shërbimit Zjarrfikës**. Prezantoni veten me emër e mbiemër. Tregoni se ku jeni (vëndndodhjen e saktë). Tregoni vëndndodhjen e zjarrit (duke dhënë pikat orjentuese sa me te sakta, emrin e vendit, vëndbanimit më të afërt apo objekte te njohura). Tregoni llojin e bimësisë që po digjet (dru, shkurre, bar etj) Nëse vëreni dicka të dyshimtë afer vatrës së zjarrit psh automjet mundohuni të shënoni targën apo ta mbani mend. Nëse vlerësoni se mund të shuani zjarrin me mjete rrethanore atëhere ndërhyuni, ne të kundërt largohuni në një distancë te sigurt. Me qëllim që të kuptoheni me personin në telefon jeni të lutur të flisni qartë dhe ngadalë. Informacioni i dhënë në këtë mënyrë është i saktë dhe përmban të gjitha elementet e nevojshme, përcaktimi i vatrës së zjarrit, lloji i materialit djegës, nëse zjarri ka qënë i qëllimshëm etj. Plani i masave për parandalimin dhe menaxhimin e zjarreve në fondin pyjor/kullor.

Përfundime:

Për sa më sipër bazuar në pikën 4c të nenit 30 të Ligjit nr 57/2020 "Për pyjet" kërkojmë nga Këshilli i Bashkisë miratimin e "Planit të Masave për parandalimin dhe shuarjen e zjarreve në fondin pyjor/kullosor" për vitin 2026" sipas materialit bashkelidhur.

Duke ju falenderuar!

KRYETARI
Gledian Llatja

NË MUNGESË DHE ME URDHËR
ZV. KRYETARI

Asim Sula



Konceptoi: H. Idrizi

Punoi: A. Muça

Miratoi: L. Haxhiymeri

Konfirmoi: Sh. Çullhaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN

MIRATOHE T
ZV/KRYETARI

Asim Sula

PROGRAM - PUNE

MASAT PËR MBROJTJEN, PARANDALIMIN DHE SHUARJEN E ZJARREVE NË FONDIN
PYJOR E KULLOSOR TË BASHKISË ELBASAN

Drejtori i Drejtorisë së Përgjithëshme së Mbrojtjes Civile, Mjedisit, Buiqësisë, Pyeve dhe Kullotave

Shpëtim Çullhaj

2026

BAZA LIGJORE:

- ◆ Ligji Nr. 152/2015, datë 21.12.2015 “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”, neni 7/1, neni 9/b, neni 13/1, i ndryshuar;
- ◆ Ligji Nr.57, datë 30.04.2020 “Për pyjet”, neni 30, pika 3, 4;
- ◆ Ligji Nr.139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 27 pika 5, neni 71, pika c;
- ◆ Ligji Nr.9693, datë 19.3.2007 “Për fondin kullorosor” i ndryshuar;
- ◆ Ligji Nr.10 431, datë 09.06. 2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit”;
- ◆ VKM Nr.288, datë 27.06.2002 “Për përcaktimin dhe marrjen e masave kundra zjarrit dhe shpëtimin në objekt me rëndësi ekonomike dhe shtetërore”;
- ◆ VKM. Nr. 290, datë 30.04.2004 “Për miratimin e strategjisë kombëtare dhe menaxhimin e zjarreve në pyje e kullota”;
- ◆ VKM Nr.1080, datë 22.12.2010 “Për rregullat në parandalimin dhe shuarjen e zjarreve në pyje dhe kullota, si dhe për krijimin e njësjve vullnetare të shuarjes së zjarreve”.

Nr.		MASAT QË DO TË MERREN				AFATI	ZBATUESI
- Në Bashkinë Elbasan organizohet shtabi i MNZSH-së në nivel Bashkie me këtë përbërje:							
Nr	Emër e Mbiemër	Detyra që kryen	Funk. në shtab	Nr. telefonit			
1.	Asim Sula	N / Kryetar i Bashkisë	Kryetar	0697288117			
2.	Shpëtim Çullhaj	Drej. Përgjithshëm i Mbrojtjes Civile, Mjedisit, Bujqësisë, Pyjeve e Kullotave	N / Kryetar	0674567988	Deri më: 31.05.2026		
3.	Klevis Çullhaj	Drej. Përgj. Agj. Mbikqyrjes dhe Kontrollit	Antar	0696033952	Drejtori i Përgjithshëm i Mbrojtjes Civile, Mjedisit, Bujqësisë, Pyjeve e Kullotave		
4.	Lorena Haxhiymeri	Drejtor i Politikave PBMPS	"	0696571871	Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë Mbikqyrjes dhe kontrollit		
5.	Eraldo Hazizolli	Drejtor i Pyjeve dhe Bujqësisë	"	0693277101	Drejtori i Pyjeve dhe Bujqësisë		
6.	Emirjon Sota	Drejtor i Drejtorisë së MNZSH-së	"	0694111034			
7.	Alketa Merkja	Drejtor i Drejtorisë së Financës	"	0695558300			
8.	Altin Cenolli	Drejtor Agj. Shërbimeve Publike Rurale	"	0693311212			
9.	Ndriçim Sinani	Drejtor Mbrojtjes Civile	"	0694901627			
10.	Armand Muça	Administrator i Nj. Ad. Bradashesh	"	0696512052			
11.	Detin Haka	Administrator i Nj. Ad. Gracen	"	0693234610			
12.	Fisnik Bozha	Administrator i Nj. Ad. Funar	"	0695161157			
13.	Resul Hoxha	Administrator i Nj. Ad. Gjergjan	"	0686458676			
14.	Emanuel Hida	Administrator i Nj. Ad. Gjinar	"	0675451320			
15.	Islam Kaçuli	Administ. i Nj. Ad. Labinot-Fushë	Antar	0693623688	Kryetari i Bashkisë		
16.	Ylber Kuci	Administ. i Nj. Ad. Labinot-Mal	"	0693014065	Drejtori i PMCMBPK		
17.	Arjan Vrapit	Administrator i Nj. Ad. Papër	"	0685680828	Drejtori i Pyjeve dhe Bujqësisë		
18.	Ibrahim Roçi	Administrator i Nj. Ad. Shirgjan	"	0696409062			
19.	Sokol Sinani	Administrator i Nj. Ad. Shushicë	"	0682541315	Deri më: 31.05.2026		
20.	Mërkur Koçi	Administrator i Nj. Ad. Tregan	"	0682230159			
21.	Ervis Dedja	Administrator i Nj. Ad. Zavalinë	"	0696263545			

2.	Si rregull, shtabi mblihdhet çdo muaj për analizë e informim, por sipas rështit, mblihdhet për të analizuar rastet e zjarreve e problemeve të ndryshme.	Maj-Tetor	Kryetari i shtabit Administratorët Insp. zonave pyjore Kryetarët e fshatrave DPMCMBPK
3.	Në Njësitë Administrative Bradashesh, Funar, Gracen, Gjergjan, Gjinar, Labinot-Fushë, Labinot-Mal, Papërr, Shirgjan, Shushicë, Tregan, Zavalinë të ngrihen shtabet në nivel lokal, sipas formularit përkatës dhe të sillet një kopje në Bashkinë Elbasan (Drejtoria e Pyjeve dhe Bujqësisë, pranë ASHPR).		Administratorët Insp. zonave pyjore Kryetarët e fshatrave
4.	Të realizohen takime në NJ.Adm. me pjesëmarrjen e kyetarëve të fshatrave për diskutimin e problemeve të MNZSH-së dhe për organizimin e Skuadrave Vullnetare të MNZSH-së në bazë fshati. Një kopje e dokumentit përkatës të sillet në Bashkinë Elbasan (Drejtoria e Pyjeve dhe Bujqësisë). Gjithashtu të organizohet bashkëpunimi dhe me subjektet e ndryshme që do të ushtrojnë aktivitet në fondin pyjor e kulloror me pronarët e pyjeve private.		Drej. Përgjithshëm i Mbrojtjes Civile, Mjedisit, Bujqësisë, Pyjeve e Kullotave (DPMCMBPK)
5.	Nga çdo NJ.Adm. të përcaktohen nevojat për: Mjete e pajisje për shuarjen e zjarreve, qendrat ose vendet ku do të vendosen dhe personat përgjegjës. Tabela propogandistike në shërbim të MNZSH-së.	Deri më: 05.06.2026	Administratorët Insp. zonave pyjore DPMCMBPK
6.	Agjencia e Shërbimit Publike Rurale, pasi të studiojë kërkesat të bashkëpunojë me Drejtorinë e Emergjencave Civile, Drejtorinë e MNZSH-së dhe Drejtorinë e Financës etj., për sigurimin e mjeteve e pajisjeve të nevojshme.		DPMCMBPK Drejtoria Financës Drejtoria MNZSH-së Drejtoria Emergjencave Civile
7.	Nga çdo NJ.Ad. të përcaktohen objektet/zonat pyjore me rrezikshmëri të lartë zjari dhe të propozojnë nevojat për të vendosur vrojtues në periudhën e nevojshme (Qershor-Tetor) Drejtoritë përgjegjëse në Bashki përcakton fondet e nevojshme për pagesat për shuarjen e zjarreve: - Karburant; - Paguesa e pjesëmarrësve; - të tjera.	Deri më: 15.06.2026	Administratorët Specialisti i pyjeve DPMCMBPK Drejtoria Financës Drejtoria Emergjencave Civile
9.	Mbi bazën e të dhënave të grumbulluara nga NJ.Ad. të hartohet Plani i Menaxhimit të Zjarreve në Pyje e Kullota për vitin 2026.	Deri më: 30.06.2026	Drejtoria Emergjencave Civile
10.	Sigurimi i bashkëpunimit dhe bashkërendimit të punës me institucione të Bashkisë: ♦ Drejtoria e Emergjencave Civile	Deri më: 15.06.2026	Drej. Përgjithshëm i Mbrojtjes Civile, Mjedisit, Bujqësisë,

	<ul style="list-style-type: none"> ◆ Drejtoria e MNZSH-së ◆ Drejtoria e Financës <p>Dhe me institucionet e tjera, duke siguruar numrat e telefonëve të personave të ngarkuar sipas strukturës specifike të secilit institucion.</p> <ul style="list-style-type: none"> ◆ Drejtoria e Policisë së Shtetit ◆ Drejtoria e Emergjencave Civile në Prefekturë ◆ Inspektoriat Kombëtar i Mjedisit dhe Teritorit ◆ Bashkitë kufitare: Cërrik, Librazhd, Prrerjas, Peqin, Gramsh dhe Tiranë. 		Pyjeve e Kullotave (DPMCMBPK)
11.			
12.	<ul style="list-style-type: none"> ◆ Në bashkëpunim me Prefekturën të përcaktohen (nëse ka) zonat e minuara ose zona me municione të paasgjësuar. (pika 4.9 e Programit të punës të Ministrisë së Mjedisit e "Për parandalimin dhe mbrojtjen e pyjeve dhe kullotave nga zjarri për vitin 2026). 	Deri më: 15.07.2026	Drej. Përgjithshëm i Mbrojtjes Civile, Mjedisit, Bujqësisë, Pyjeve e Kullotave (DPMCMBPK).
13.	<p>Masa propogandistike:</p> <ul style="list-style-type: none"> ◆ Emisione televizive në mediat lokale. ◆ Njoffimi i mediave lokale për sensibilizimin e popullatës. ◆ Artikuj në shtyp. 	Maj-Tetor 2026	Shtabi i MNZSH-së
14.	<p>Organizimi i Shërbimit të MNZSH-së në Bashkinë Elbasan:</p> <ul style="list-style-type: none"> ◆ Për periudhën Maj-Tetor organizohet shërbim gatishmërie në zyrën e Informacionit të Bashkisë ◆ Përgjegjës për organizimin e shërbimit (hartimin e listës së shërbimit, kontrollin e kryerjes së shërbimit dhe pritjen e përcjelljen e informacionit) është Përgjegjësi i Menaxhimit dhe Mbrojtjes së Pyjeve. 	Maj-Tetor 2026	Shtabi i MNZSH-së. Përgjegjësi i Menaxhimit dhe Mbrojtjes së Pyjeve në ASHPR
15.	<p>Në Agjencia e Shërbimit Publike Rurale.</p> <ul style="list-style-type: none"> ◆ Shërbimi kryhet nga punonjësit e Bashkisë sipas një grafiku të miratuar nga Kryetari i Shtabit të MNZSH-së. ◆ Në këtë shërbim nuk përfshihen punonjësit e Agjencia e Shërbimit Publike Rurale. ◆ Punonjësit e Drejtorisë së Pyjeve dhe Bujqësisë do të veprojnë në terren për organizimin, koordinimin e kontrollin për shuarjen e zjarrit dhe verifikimin e dëmeve. -Lista, grafiku, ndërtimi i grupeve, funksionimi etj. bëhet me urdhër të Drejtorit të Drejtorisë. ◆ Marrja dhe përcjellja e informacionit do të bëhet nga punonjësi i shërbimit duke u pasqyruar në një regjistër të posaçëm. ◆ Për periudhën Maj-Tetor pranë Agjencia e Shërbimit Publike Rurale, do të jetë në gatishmëri 24 orë një automjet për lëvizjen e personelit që do të marrë pjesë në organizimin e kontrollin e shuarjes së zjarreve. 	Maj-Tetor 2026	Nëpunësi i Shërbimit.

	<ul style="list-style-type: none"> ◆ Punonjësi i shërbimit ka për detyrë: - Të mbajë në gatishmëri numrin e telefonit që ka të vendosur në këndin e MNZSH-së - Të marrë informacione, ti përcjellë ata në strukturat përkatëse (në zyrë e në terren) për të siguruar informacionin e nevojshëm dhe merret me organizimin e shuarjes së zjarrit. - Informon sipas rastit, strukturat sipas SKEMËS SË LAJMËRIMIT 		
<p>16.</p>	<p>Marrja e përcjellja e informacionit.</p> <ul style="list-style-type: none"> ◆ Në këndin e MNZSH-së në Bashki dhe NJ.Ad. të vendosen SKEMAT E LAJMËRIMIT. ◆ NJ.Ad. për çdo rast zjarri të njoftojnë menjëherë bashkinë (Shërbimin e gatishmërisë), Pyjeve në Agjencia e Shërbimit Publike Rurale. ◆ Përgjegjësi i Sektorit të Mbrojtjes së Pyjeve në Agjencia e Shërbimit Publike Rurale, pasi ka siguruar të dhënat e nevojshme për vendndodhjen e zjarrit, mundësitë teknike të ndërhyrjes etj. njofton Drejtorinë e MNZSH-së dhe së bashku marrin masat e nevojshme për ndërhyrje. ◆ Për çdo rast zjarri nga Përgjegjësi i Menaxhimit dhe Mbrojtjes së Pyjeve në Agjencia e Shërbimit Publike Rurale, njoftohet: <ul style="list-style-type: none"> a. Agjencia Kombëtare e Pyjeve (AKP) në numër tel. 0699377771. b. Prefektura në numër tel. 0694117152 c. Policia e Rendit 	<p>Maj-Tetor 2026</p>	<p>Përgjegjësi i Menaxhimit dhe të Mbrojtjes së Pyjeve në ASHPR.</p>
<p>17.</p>	<ul style="list-style-type: none"> ◆ Pasqyrimi në Dokumentet e Kadastrës Pyjore i dëmeve e pasojave të zjarreve bëhet në bazë të dokumentacionit të përgatitur sipas evidencave përkatëse standarte. 	<p>Vazhdimisht</p>	<p>Specialisti i kadastrës.</p>

Përgatiti: Ing. Astrit Muça



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

PROJEKT VENDIM

Nr. ____ datë ____ . ____ 2026

**“PËR MIRATIMIN E PLANIT TË PARANDALIMIT DHE SHUARJES SË ZJARREVE
NË FONDIN PYJOR KOMBËTAR, BASHKIA ELBASAN”**

Në mbështetje të neni 27 pika 5 e ligjit nr. 139, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjit nr. 152/2015, datë 21.12.2015 “Për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin”, i ndryshuar; ligjit nr. 57, datë 30.04.2020 “Për Pyjet”, neni 30 pika 4/c, i ndryshuar; VKM nr. 1186, datë 24.12.2020 “Për miratimin e listës së objekteve me rëndësi ekonomike e strategjike, pranë të cilave ngrihen stacionet e shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”; VKM nr. 290, datë 30.04.2004 “Për Miratimin Strategjik Kombëtar dhe Menaxhimin e Zjarreve në Pyje e Kullota”; VKM nr.1080, datë 22.12.2010 “Për Rregullat në Parandalimin dhe Shuarjen e Zjarreve në Pyje dhe Kullota si dhe për krijimin e Njësisë Vullnetare të Shuarjes së Zjarreve”; VKM nr. 433, datë 08.06.2016 “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave publike, sipas listës së inventareve, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish komunave/bashkive”, i ndryshuar,

V E N D O S I

1. Miratimin e planit të masave për parandalimin dhe shuarjen e zjarreve në fondin pyjor kombëtar të bashkisë Elbasan.
2. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria MNZSH_së, Agjencia e Shërbimëve Publike Rurale, Agjencia e Emergjencave Civile, Njësitë Administrative të Bashkisë Elbasan dhe Drejtoria e Pyjeve dhe Bujqësisë pranë Agjencisë së Shërbimeve Publike Rurale (ASHPR).
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes publike (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”).

K R Y E T A R I

Lutfi Lala

Konceptoi: Hasan Idrizi

Pranoi: Astrit Muça

Miratoi: Lorena Haxhiymeri

Konfirmoi: Shpetim Çullhaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN

Nr. 2114 Prot.

Elbasan, më: 16.04.2026.

RELACION

“Mbi miratimin në parim të fillimit të procedurës për shpronësimin e pasurive pronë private për realizimin e projektit me interes publik “Zgjerimi i rrugës “Petrin Kallajxhiu”, ndodhur në Z.K 8522”, nga Bashkia Elbasan dhe burimin e financimit të këtij shpronësimi”.

KËSHILLIT BASHKIAK

K Ë T U

Të nderuar Këshilltarë,

Bazuar në ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar; në ligjin nr. 8561 datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik”, i ndryshuar, Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit të Territorit dhe Punëve Publike si dhe Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Mbështetëse, i relatton Këshillit Bashkiak si në vijim:

- Projekti me interes publik “Zgjerimi i rrugës “Petrin Kallajxhiu”, ndodhur në Z.K 8522”, prek pasurinë “pronë private”, paraqitur në planvendosjen bashkëlidhur.
- Burimi i financimit për shpronësimin e pasurive të prekura nga projekti i lartpërmendur do të mbulohej nga buxheti i Bashkisë Elbasan për vitin 2026.

Për sa më sipër i relatohet Këshillit Bashkiak të miratojë në parim fillimin e procedurës së shpronësimit për projektin me interes publik “Zgjerimi i rrugës “Petrin Kallajxhiu”, ndodhur në Z.K 8522”, si dhe mbulimin financiar të këtij shpronësimi.

Me urdhër e porosi
ZV/KRYETAR
Klaudia Krasniqa



KRYETARI
Gledian Llatja

Konceptoi: A. Braneshi
Drejtoria P.P.S:
Drejtoria F.B.:
Drejtoria P.U: E. Mihal
Drejtoria D.P.P.D.U:
Drejtoria P.Sh.M:

G. Kerri
G. Dyrmyshi
A. Pisha
A. Merkja
M. Avllazagari
K. Haxhihyseni
S. Mehmeti



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. ____ Prot.

Elbasan, më: ____ . ____ .2026.

PROJEKT – VENDIM

Nr. ____ Datë: ____ . ____ .2026.

“Mbi miratimin në parim të fillimit të procedurës për shpronësimin e pasurive pronë private për realizimin e projektit me interes publik “Zgjerimi i rrugës “Petrit Kallajxhiu”, ndodhur në Z.K 8522”, nga Bashkia Elbasan dhe burimin e financimit të këtij shpronësimi”.

Bazuar në ligjin Nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar, në ligjin nr. 8561 datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik”, i ndryshuar, Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të datës ____ . ____ .2026 pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Mbështetëse dhe Drejtoria Përgjithshme e Zhvillimit të Territorit dhe Punëve Publike:

VENDOSI:

1. Miratimin në parim për fillimin e procedurës së shpronësimit për pasuritë pronë private që preken nga realizimi i projektit me interes publik “Zgjerimi i rrugës “Petrit Kallajxhiu”, ndodhur në Z.K 8522”. (planvendosje bashkëlidhur).
2. Miratimin e burimit të financimit për shpronësimin e pasurive të prekura nga projekti i lartpërmendur, i cili do të mbulohet nga buxheti i Bashkisë Elbasan për vitin 2026.
3. Për zbatimin e këtij vendimi dhe vazhdimësinë e procedurës së mëtejshme ngarkohet Komisioni i Shpronësimit, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Mbështetëse dhe Drejtoria Përgjithshme e Zhvillimit të Territorit dhe Punëve Publike.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

SEKRETARI

Elsid Zyma

KRYETARI

Lutfi Lala

Konceptoi: A. Braneshi

Drejtoria P.P.S:

Drejtoria F.B.:

Drejtoria P.U: E. Mihali

Drejtoria D.P.P.D.U:

Drejtoria P.Sh.M:

Drejtoria J. I:

Zv/Kryetar:

G. Kerri

G. Dyrmyshi

P/A. Merkja


M. Avllazagaj

K. Haxhihyseni

S. Mehmeti

A. Hoxha

K. Krasnika




**PLANVENDOSJA E ZGJERIMIT TE RRUGES PETRIT KALLAJXHIU
VENDNDODHJA :ELBASAN : QYTETI ELBASAN
ZK. 8522 INDEKSI I HARTES EL: P-10**



**MIRATOI
KRYETARI I BASHKISE
GLEDIAN LLATJA**



SHKALLA SH 1:1000



BASHKIA ELBASAN
DREJTORIA E PRONAVE PUBLIKE DHE STREHIMIT
Drejtör GENTIAN DYRMYSHI
Ing. Gjeodet GENTIANA KERRI
Dt. 15/04/2026



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
AGJENCIA SHËRBIMEVE PUBLIKE RURALE

Nr. 2196 Prot

Datë 20.04.2026

RELACION

“Për një shtesë në vendimin e VKB nr 16 dt.29.01.2025 “Për miratimin e normave dhe kriterëve për disiplinimin e shpenzimeve për mjete motorrike në administrim të ASHPR.”

KËSHILLIT BASHKIAK

Të nderuar Këshilltarë,

Bazuar në ligjin Nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” i ndryshuar, neni 54, ”, të ligjit Nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik, ”

Komisioni për përcaktimin e normativave të mjeteve motorrike për vitin 2026 i ngritur sipas urdhërit të brendshëm nr.3 dt.06.01.2026 prot.05 ,pasi bëri vlerësimin e harxhimit të karburantit për mjetin e ri të blera nga ASHPR (sipas procedurave të prokurimit për vitin 2025-2026) hartoj procesverbalin përkatës dhe vendosi që norma e harxhimit të karburantit të jetë përkatësisht si më poshtë:

Nr	Targa e mjetit	Tipi I mjetit	Norma e konsumit	Karburanti
1	AB552YN	Makinë Pastrimi(DAF LF210) Nr.shasisë: XLRAEL1500L466156	4 Litra/orë pune	GazoiL D1
		Viti prodhimit 2017		

Bashkëngjitur relacionit është procesverbali përkatës.

Konceptoi: S.Finance Drilona Mema
P/Sek mekanik Gazmend Gaxhja

Pranoi:Drejtor Drejtorie/ Klaudio Tusha
Miratoi:Drejtori i Përgjithshëm/Altin Cenolli

KRYETARI
Gledian Llatja

Me urdhër e porosi
ZV/KRYETAR
Klaudia Krasnika



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
AGJENCIA SHERBIMEVE PUBLIKE RURALE

Nr. 511 Prot

Dt. 16.04.2026

PROCES VERBAL

Mbështetur në Ligjin Nr.139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore; në Ligjin Nr 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" për nevojat e përdorimit racional dhe të përditshëm të karburantit

Mbahet ky procesverbal në prani të komisionit të ngritur me urdhërin nr.3 dt 06.01.2026 nr prot.05.

Anetarët e komisionit:

- Gazmend Gaxhja
- Drilona Mema
- Gejsi Luta

Në bazë të verifikimit të fakteve dhe provave konkludohet si më poshtë :

- Automjeti tip DAF LF210(Makinë Pastrimi)viti prodhimit 2017, me targë AB552YN harxhon 4 Litra/Orë pune Gazoil D1

Në përcaktimin e normativave u mbajten parasysh normativat egzistuese, disa tregues të rëndësishëm sic jane viti i prodhimit , tipi e lloji i mjetit, amortizimi i tij, gjendja reale teknike e mjetit, rrugët që do te përshkohen, ndalesa në semafore, trafiku ne qytet, natyra e punës për makinerinë e rënde, nevojat e përdorimit të funksioneve shtesë etj.

KOMISION

Gazmend Gaxhja

Drilona Mema

Gejsi Luta

DREJTOR I PËRGJITHSHEM

Altin Cenolli





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK ELBASAN

Nr. ____ Prot

Datë _____.____.2026

PROJEKT VENDIM

Nr. ____ Datë _____.____.2026

“Për një shtesë në vendimin e VKB nr 16 dt.29.01.2025 “Për miratimin e normave dhe kriterëve për disiplinimin e shpenzimeve për mjete motorrike në administrim të ASHPR.”

Bazuar në ligjin Nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” i ndryshuar, neni 54, ”, të ligjit Nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik,,”

Relacionit të paraqitur nga ASHPR nr. ____ datë: _____

VENDOSI :

1. Të miratojë normën e harxhimit të karburantit për mjetet perkatësisht si më poshtë:.

Nr	Targa e mjetit	Tipi I mjetit	Norma e konsumit	Karburanti
1	AB552YN	Makinë Pastrimi(DAF LF210) Nr.shasisë: XLRAEL1500L466156	4 Litra/orë pune	GazoiL D1
		Viti prodhimit 2017		

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Agjencia e Shërbimeve Publike Rurale _.

3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

Konceptoi: S.Finance Drilona Mema

P/Sek mekanik Gazmend Gaxhja

Pranoi:Drejtor Drejtorie/ Klaudio Tusha

Miratoi:Drejtori i Përgjithshëm/Altin Cenolli

Konfirmoi: Zv.Kryetar Klaudia Krasnika

Sekretari i Këshillit Bashkiak

ELSID ZYMA

Kryetari i Këshillit Bashkiak

LUTFI LALA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TË ZHVILLIMIT EKONOMIK KULTURËS DHE
TURIZMIT
DREJTORIA E POLITKAVE TË TURIZMIT DHE TRASHËGIMISË KULTURORE
SEKTORI I PROMOVIMIT TË TURIZMIT

Nr. 2160 Prot.

Elbasan 17.04.2026

RELACION

“Për miratimin e hapjes së shtegut turistik Dopaj–Funar dhe vendosjen e sinjalistikës orientuese, financuar nga projekti ‘Krushevo and Elbasan – Journey in Nature and Adventure’ (Grant No. 2025/487-660)”

Të nderuar anëtarë të Këshillit Bashkiak,

Në kuadër të zhvillimit të turizmit natyror dhe promovimit të zonave me potencial të lartë turistik në territorin e Bashkisë Elbasan, është parashikuar realizimi i projektit për hapjen e shtegut turistik Dopaj–Funar dhe vendosjen e sinjalistikës orientuese përkatëse.

Ky projekt realizohet në kuadër të Programit IPA Cross-Border Cooperation, konkretisht përmes projektit **“Krushevo and Elbasan – Journey in Nature and Adventure” (Grant No. 2025/487-660)**, i cili synon nxitjen e bashkëpunimit ndërkufitar dhe zhvillimin e qëndrueshëm të zonave rurale përmes turizmit natyror dhe aktiviteteve aventuriere.

Bashkia Elbasan, në cilësinë e përfituesit dhe zbatuesit të projektit, ka ndërmarrë hapat e nevojshëm për implementimin e tij në terren, duke angazhuar strukturat përkatëse për realizimin e ndërhyrjeve të planifikuara.

Ndërhyrja konsiston në:

- Hapjen dhe pastrimin e shtegut natyror-turistik Dopaj–Funar;
- Sistemimin e terrenit për të garantuar kalueshmëri të sigurt për vizitorët;
- Vendosjen e sinjalistikës orientuese dhe informuese përgjatë itinerarit;
- Identifikimin dhe shënimin e pikave me interes turistik dhe natyror.

Nga verifikimet në terren rezulton se aktualisht shtegu ekziston pjesërisht, por është i paaksesueshëm dhe i pasigurt për shkak të mungesës së mirëmbajtjes, degradimit të terrenit dhe mungesës së sinjalistikës orientuese.

Në këto kushte, ndërhyrja paraqitet e domosdoshme për:

- Rritjen e sigurisë së vizitorëve;
- Përmirësimin e aksesit në zonë;
- Zhvillimin e turizmit natyror dhe ekonomik lokal;
- Promovimin e burimeve natyrore dhe kulturore të zonës së Funarit.

Financimi i këtij projekti është siguruar nga fondet e Programit IPA Cross-Border Cooperation, dhe buxhetit të miratuar dhe të angazhimeve administrative dhe zbatuese nga ana e Bashkisë Elbasan, në kuadër të projektit të sipërcituar.


Zbatimi i projektit do të kryhet në përputhje me standardet mjedisore dhe teknike, duke synuar minimizimin e ndikimit në mjedis dhe ruajtjen e ekosistemit natyror.

Për sa më sipër, propozohet që Këshilli Bashkiak i Elbasanit të miratojë:

- Hapjen dhe sistemimin e shtegut turistik Dopaj-Funar;
- Vendosjen e sinjalistikës orientuese përkatëse;
- Zbatimin e projektit në kuadër të projektit “Krushevo and Elbasan – Journey in Nature and Adventure” (Grant No. 2025/487-660).

Bashkëngjitur do të gjeni dokumentacionin përkatës.

Konceptoi:	Përgjegjëse	E.Krraba
Miratoi:	Drejtori DPTTK	A.Guni
Konfirmoi:	Drejtori DPZHEKT	A.Canaj



Me Urdhër e Porosi
ZV/KRYETARË
Klaudia KRASNIKA



KRYETARI
Gledian LLATJA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. ____ Prot.

Elbasan ____. ____. 2026

PROJEKT - VENDIM

Nr. ____ datë: ____. ____. 2026

“ Për miratimin e hapjes së shtegut turistik Dopaj–Funar dhe vendosjen e sinjalistikës orientuese, financuar nga projekti ‘Krushevo and Elbasan – Journey in Nature and Adventure’ (Grant No. 2025/487-660)”

Këshilli Bashkiak, në mbledhjen e tij të datës ____. ____. 2026, pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Politikave të Turizmit dhe Trashëgimisë Kulturore (Sektori i Promovimit të Turizmit), “Për miratimin e hapjes së shtegut turistik Dopaj–Funar dhe vendosjen e sinjalistikës orientuese, financuar nga projekti ‘Krushevo and Elbasan – Journey in Nature and Adventure’ (Grant No. 2025/487-660)”, mbështetur në nenin 17 të ligjit nr.139/2015 “Për vetë qeverisjen vendore”(i ndryshuar), Ligj. Nr. 93/2015 “Për Turizmin” i përditësuar, në Republikën e Shqipërisë”

VENDOSI:

1. Miratimin e hapjes së shtegut turistik Dopaj–Funar dhe vendosjen e sinjalistikës orientuese, financuar nga projekti ‘Krushevo and Elbasan – Journey in Nature and Adventure’ (Grant No. 2025/487-660)”.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Administrata dhe Kryetari i Bashkisë.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

SEKRETARI
Elsid ZYMA

KRYETARI
Lutfi LALA

Konceptoi:

Përgjegjëse E.Krraba
Drejtori DPTTK A.Guni
Drejtori DPZHEKT A.Canaj
Drejtorja Juridike: A.Hoxha



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK**

Nr. 225 Prot.

Elbasan më 20 04.2026

RELACION

DREJTUAR: Këshilli Bashkiak Elbasan

NGA: Drejtoria e Planifikimit, Zhvillimit Ekonomik dhe Transportit, Sektori licencimeve të transportit Bashkia Elbasan.

LËNDA: Për miratimin e përdorimit të biletës së fiskalizuar dhe biletës elektronike në transportin publik qytetës dhe rrethqytetës.

1. Qëllimi i relacionit

Projektvendimi ka për qëllim krijimin e bazës së nevojshme rregullatore për modernizimin e sistemit të biletimit në transportin publik, nëpërmjet përdorimit të biletës së fiskalizuar dhe implementimit të sistemeve të biletimit elektronik (dixhital). Nëpërmjet këtij akti synohet gjithashtu krijimi i mekanizmave për mbledhjen, përpunimin dhe analizën e të dhënave mbi funksionimin e shërbimit.

2. Baza ligjore dhe arsyeja e nismës

Hartimi i këtij projektvendimi mbështetet në kuadrin ligjor në fuqi për transportin publik dhe fiskalizimin, si dhe në detyrimin e njëjësive të vetëqeverisjes vendore për të përcaktuar formën e biletimit që zbatohet brenda juridiksionit të tyre.

Në këtë kontekst:

- Njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë kompetencën për të përcaktuar nëse shërbimi i transportit publik do të operojë me bileta me çmim të parashtypur apo me sistem biletimi elektronik;
- Në rast të aplikimit të biletimit elektronik, ekziston detyrimi për njoftimin paraprak të administratës tatimore, me qëllim koordinimin e kërkesave dhe procedurave përkatëse.

Gjithashtu, nisma është nxitur edhe nga kërkesa e operatorit të shërbimit të transportit publik qytetës, Elbasan Bus sh.p.k., depozituar me nr. protokollit 828, datë 07.04.2026, për përshtatjen e mënyrës së biletimit në përputhje me zhvillimet ligjore dhe teknologjike.

3. Gjendja aktuale dhe problematikat

Analiza e situatës aktuale evidencon disa problematika kryesore:

- Përdorimi dominues i pagesave cash, që rrit riskun e informalitetit;
- Mungesa e të dhënave të sakta mbi numrin real të udhëtarëve;
- Vështirësi në kontrollin dhe verifikimin e zbatimit të tarifave;
- Kufizime në monitorimin e performancës së operatorëve;
- Mungesë informacioni të strukturuar për planifikimin dhe përmirësimin e shërbimit.

4. Nevoja dhe efektet e pritshme të vendimit

Miratimi i këtij projektvendimi pritet të sjellë:

- Rritje të transparencës dhe ulje të nivelit të informalitetit në sektor;
- Dixhitalizim të shërbimit dhe përmirësim të menaxhimit operacional;
- Krijimin e një sistemi të integruar monitorimi për Bashkinë;
- Lehtësim të përputhshmërisë së operatorëve me kërkesat e fiskalizimit;
- Përmirësim të cilësisë së shërbimit për qytetarët nëpërmjet vendimmarrjes së bazuar në të dhëna.

5. Roli i Bashkisë

Bashkia, në cilësinë e autoritetit rregullator dhe mbikëqyrës, garanton ndërtimin dhe administrimin e kuadrit teknologjik dhe rregullator për funksionimin e sistemit të biletimit dhe monitorimit.

Në këtë kuadër:

- Bashkia nuk ndërhyt në administrimin e të ardhurave të operatorëve;
- Siguron mbledhjen dhe analizën e të dhënave për qëllime monitorimi dhe përmirësimi të shërbimit;
- Ushtron funksionin e kontrollit dhe vlerësimit të performancës së shërbimit publik.

6. Lidhja me objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm (“Net Zero City 2030”)

Implementimi i biletimit elektronik dhe dixhitalizimi i transportit publik përbën një komponent të rëndësishëm në kuadër të objektivave për zhvillim të qëndrueshëm urban dhe reduktim të emetimeve.

Ky proces kontribuon në:

- Optimizimin e rrjeteve të transportit;
- Uljen e përdorimit të automjeteve private;
- Përmirësimin e eficiencës energjetike dhe operacionale;
- Mbështetjen e politikave për qytete inteligjente dhe me emetime të ulëta.

7. Standardet teknike dhe përputhshmëria me praktikën evropiane

Sistemet e propozuara të biletimit elektronik duhet të jenë në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe evropiane, ndër të cilat:

- Ligji nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar;
- ISO/IEC 14443 (teknologjitë “contactless”);
- ISO/IEC 7810 (specifikimet fizike të kartave);
- Standardet EMV për pagesat elektronike;
- ISO/IEC 27001 për sigurinë e informacionit;
- ISO 37120 për zhvillimin e qyteteve inteligjente dhe të qëndrueshme.

8. Përfitimet për qytetarët


Zbatimi i këtij sistemi sjell përfitime të drejtpërdrejta për përdoruesit e shërbimit:

- Lehtësi dhe fleksibilitet në pagesë (reduktim i përdorimit të cash-it);
- Transparencë më e lartë në tarifim;
- Shërbim më cilësor dhe i monitoruar;
- Mundësi për zhvillimin e shërbimeve shtesë (abonime, tarifa të diferencuara, etj.).

9. Përfundime

Në përfundim, projektvendimi përbën një hap të domosdoshëm drejt modernizimit të shërbimit të transportit publik, rritjes së transparencës dhe përmirësimit të menaxhimit të tij, duke e përafëruar atë me standardet bashkëkohore dhe objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm.

Konceptoi: D. Celibashi
Pranoi: K. Çekrezi
Miratoi: A. Canaj



KRYETARI
Gledian Llatja

NË MUNGESË DHE ME URDHËR
NËN KRYETARI
Klaudia Krasnika





**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK**

Nr ____ Prot.

Elbasan më ____ . ____ .2026

PROJEKT VENDIM

Nr ____ Datë ____ . ____ .2026

**PËR MIRATIMIN E PËRDORIMIT TË BILETËS SË FISKALIZUAR DHE
BILETËS ELEKTRONIKE NË TRANSPORTIN PUBLIK QYTETËS DHE
RRETHQYTETËS**

Në mbështetje të:

- Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” të ndryshuar;
- Ligjit nr. 8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore”, të ndryshuar;
- Ligjit nr. 87/2019 “Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit”, të ndryshuar;
- Vendimit nr. 85, datë 8.2.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e rregullave për prodhimin, shpërndarjen dhe pajisjen e udhëtarëve me bileta transporti rrugor”, të ndryshuar;
- Udhëzim nr. 3743, datë 10.7.2017 " Mbi modelet dhe standardet e biletave të transportit rrugor të udhëtarëve ", të ndryshuar;
- Udhëzim nr. 16, datë 3.4. 2020 "Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit ";
- Udhëzim nr. 24, datë 16.6.2020 "Për regjistrimin e pagesave të faturave elektronike ";
- Ligji nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar;
- Akteve nënligjore në fuqi në fushën e fiskalizimit dhe transportit publik;

Neni 1

Objekti

Ky vendim ka për objekt miratimin e përdorimit të:

- biletës së fiskalizuar;
- biletës elektronike (digjitale);

në shërbimin e transportit publik qytetës dhe rrethqytetës të udhëtarëve, me qëllim rritjen e transparencës, përmirësimin e shërbimit dhe modernizimin e sistemit të biletimit.

Neni 2

Autoriteti dhe roli i Bashkisë

1. Bashkia, si autoritet përgjegjës për planifikimin, organizimin, rregullimin dhe mbikëqyrjen e shërbimit të transportit publik në territorin e saj administrativ, ka të drejtë të projektojë, zbatojë dhe administrojë sisteme dhe infrastrukturë teknologjike në funksion të biletimit dhe monitorimit të shërbimit, drejtpërdrejt ose nëpërmjet kontraktimit të subjekteve të treta.
2. Në ushtrim të këtyre kompetencave, Bashkia përcakton dhe miraton sistemin e biletimit që zbatohet në shërbimin e transportit publik urban, duke garantuar përputhshmërinë me legjislacionin në fuqi dhe standardet teknike përkatëse.
3. Bashkia siguron mbledhjen, administrimin dhe përpunimin e të dhënave që lidhen me funksionimin e shërbimit, përfshirë në veçanti:
 - shitjen e biletave;
 - fluksin e udhëtarëve;
 - respektimin e orareve dhe treguesit e performancës së shërbimit.
4. Operatorët e transportit janë të detyruar:
 - të zbatojnë sistemin e biletimit të miratuar nga Bashkia;
 - të kryejnë shitjen e biletave dhe administrimin e të ardhurave që rrjedhin prej tyre;
 - të zbatojnë kërkesat ligjore për fiskalizimin;
 - të sigurojnë transmetimin në kohë dhe në formatin e kërkuar të të dhënave drejt sistemit të Bashkisë.
5. Bashkia ushtron funksionin e monitorimit dhe analizës së shërbimit mbi bazën e të dhënave të mbledhura, pa ndërhyrë në administrimin financiar të operatorëve, përveç rasteve të parashikuara shprehimisht në legjislacionin në fuqi ose në marrëveshjet kontraktore.

Neni 3

Fiskalizimin i biletave

1. Çdo biletë e shitur në transportin publik qytetës dhe rrethqytetës duhet të jetë e fiskalizuar në përputhje me legjislacionin në fuqi.
2. Sistemet e përdorura nga operatorët duhet të garantojnë:
 - fiskalizim real të transaksioneve;
 - funksionim edhe në kushte offline, me raportim të mëvonshëm sipas rregullave në fuqi.

Neni 4

Biletimi elektronik

1. Lejohet përdorimi i biletave elektronike në forma të ndryshme, përfshirë por pa u kufizuar në:
 - karta elektronike Smart/NFC, (Pika 5 e udhëzimit nr. 3743, datë 10.7.2017 të ndryshuar);

- bileta me kod elektronik (p.sh. QR);
 - aplikacione mobile dhe forma të tjera digjitale.
2. Sistemet e biletimit elektronik duhet të mundësojnë:
- gjurmueshmërinë e biletës;
 - verifikimin e vlefshmërisë së saj;
 - kontrollin në terren nga strukturat përkatëse.

Neni 5

Qëllimi dhe përfitimet

Ky vendim synon:

- nxitjen e digjitalizimit të shërbimit të transportit publik;
- rritjen e transparencës, reduktimin e abuzimeve dhe informalitetit;
- përmirësimin e kontrollit mbi zbatimin e tarifave dhe orareve;
- krijimin e një baze të dhënash për analizë dhe planifikim të politikave të transportit.

Neni 6

Zbatimi i standardeve ligjore

1. Përcaktimet teknike për biletat dhe sistemet e biletimit elektronik zbatohen në përputhje me:
 - Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 85, datë 08.02.2017;
 - udhëzimin e ministrisë përgjegjëse për transportin nr. 3743, datë 10.7.2017;
 - legjislacionin tatimor në fuqi.
2. Operatorët janë të detyruar të respektojnë këto standarde në implementimin e sistemeve të tyre.

Neni 7

Akte zbatuese

Bashkia, kur është e nevojshme, miraton akte të veçanta për:

- mënyrën e raportimit të të dhënave;
- kërkesat minimale funksionale të sistemeve;
- organizimin e monitorimit dhe kontrollit.




Neni 8

Hyrja në fuqi

Ky vendim hyn në fuqi pas miratimit nga Këshilli Bashkiak dhe publikimit sipas legjislacionit në fuqi.

Sekretari
Elsid Zyma

KRYETARI
Lutfi Lala

Konceptoi:
K.Çekrezi, 
D.Celibashi 
A.Canaj 
D.Juridike: A.Hoxha



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN

Nr. 228 prot

Elbasan me 20.06. 2026

RELACION

**“PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES SË BASHKËPUNIMIT PËR
ANËTARËSIMIN E BASHKISË NË PLATFORMËN ‘RRJETI I QEVERISJEVE
VENDORE PËR QËNDRUESHMËRI (ICLEI)’.”**

KËSHILLIT BASHKIAK

Elbasan

Të nderuar anëtarë të Këshillit Bashkiak, Elbasan

Bazuar në ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, mbështetur edhe në programin: “Net ZeroCities”, financuar nga Bashkimi Europian, po ju informojmë se institucioni ynë nëpërmjet ekspertëve të platformës Net ZeroCity ka marrë një ftesë për t’iu bashkuar platformës ICLEI, Local Governments for Sustainability. Pjesëmarrja jonë në këtë platformë do të jetë në përputhje të plotësisimit të Marrëveshjen e Gjellbër Evropiane për arritjen e Misionit të Qyteteve dhe të 17 Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm. Në këtë kuadër e gjithë procedura mbështetet edhe në dakortësinë që Ju keni dhënë për vazhdimin e këtij misioni ku përmendim se më datë 09.11.2022 me vendim nr. 5232/1 ku Ju keni miratuar në parim metodologjinë që do të ndjekim sëbashku në kuadër të “Misioni i BE-së për 112 qytete neutrale klimatike dhe të zgjuara deri në vitin 2030” për të cilën kemi edhe aktin e konfirmimit nga prefekti më datë 18/11/2022 me numër 1331/1 prot.

Aktualisht në këtë platformë janë bashkuar mbi 2,500 autoritete vendore dhe rajonale në të gjithë botën që angazhohen për zhvillim të qëndrueshëm urban dhe klimatik. Kjo ftesë vjen si një njohje e angazhimit të qytetit tonë për t’u shndërruar në një qytet neutral ndaj klimës dhe inteligjent, si dhe për faktin që Elbasani është përzgjedhur si një rast i mundshëm demonstrues për automatizimin e raportimit të gazeve serrë në nivel lokal. ICLEI vepron përmes 5 “pathways” (rrugëve) të ndërlidhura: zhvillim me emetime zero, i bazuar te natyra, i barabartë, rezilient dhe rrethor duke lidhur aktorët vendorë, kombëtarë e globalë për zbatim sistemik të politikave urbane.

Përfitimet që do të ketë institucioni ynë nëpërmjet platformës ICLEI janë:

- Mbështetje teknike dhe mjete (portale, guida, asistencë një-më-një) për inventar GHG, plane veprimi, prokurim të gjellbër, etj.

- Rrjetëzim & peer-learning me qytete evropiane e botërore; shkëmbim praktikash dhe mentorim.
- Pjesëmarrje në projekte financuese të BE-së, p.sh. NetZeroCities (NZC) që mbështet Qytetet e Misionit të BE drejt neutralitetit klimatik, përfshirë Klimë City Contract (CCC)

ICLEI është partnere e konsorciumit NetZeroCities, i cili operon platformën e Misionit të Qyteteve dhe shërbimet e Climate City Contract (CCC): shërbime këshilluese, peer-learning, thirrje pilotësh dhe instrumente të financimit.

Kjo e bën anëtarësimin veçanërisht relevant për Elbasanin në fazën e zbatimit të Kontratës së Qytetit Klimatike (CCC).

Anëtarësimi është i hapur për bashki/qarqe dhe shoqata të tyre; anëtarët drejtojnë strategjinë e rrjetit dhe marrin pjesë në organet drejtuese. Rrjeti përfshin qindra qytete evropiane të profilit të lartë.

Institucioni ynë do të ketë një kuotë vjetore prej €550/vit e cila është në varësi të popullsisë (200,001–300,000).

Rëndësia e anëtarësimit:

- Përshejton zbatimin e CCC: akses në ekspertizë dhe mjete të NZC/ICLEI për modelim investimesh, menaxhim portofolësh dhe monitorim.
- Rrit kredibilitetin për financim: anëtarësimi rrit dukshmërinë dhe peshën në aplikime për fonde të BE-së dhe partnerë ndërkombëtarë.
- Rritje e profilit ndërkombëtar të qytetit, përmes përfaqësimit në platforma të rëndësishme politike dhe teknike të BE-së dhe OKB-së për çështjet e klimës.
- Akses në burime, ekspertizë dhe platforma teknike për zhvillimin e projekteve në fusha si: energjia e qëndrueshme, uji, biodiversiteti, mobiliteti, teknologjia dhe adaptimi ndaj ndryshimeve klimatike.
- Mbështetje për hartimin dhe zbatimin e strategjive vendore, përfshirë akses në trajnime, konsulencë teknike dhe mundësi financimi përmes projekteve të përbashkëta.
- Mundësi për shkëmbim përvojash dhe praktikash me qytete të tjera të përfshira në rrjet.

Nëse jepet miratimi nga ana juaj, do të vazhdojmë partneritetit duke angazhuar strukturat kompetente.

Ju faleminderit!

Konceptoi: P.S.P.D

K.Kreka

P.S.100 Q

A.Hodaj

MIRATOI: D.D.I.E.P.D

E. Çuni

D.P.ZH.E.K.T


A. Canaj

D.F.B

P/A.Merkja

KRYETARI

GLEDIAN LLATJA



MARRËVESHJE PARTNERITETIT

Kjo Marrëveshje Partneriteti (MA) në vijim ("Marrëveshja") është rënë dakord midis:

Bashkia e Elbasanit
Me selinë e regjistruar në:
Rruga 11 Nëntori, Elbasan, 3001 Shqipëri
Numri i regjistruar i PIC: 921192802
Numri i TVSH-së: K52905207B

Dhe

ICLEI - Qeveritë Vendore për Qëndrueshmëri
Sekretariati Evropian
Adresa: Leopoldring 3, 79098 Freiburg, Gjermani
Numri i TVSH-së: DE153445986
Numri i Regjistrimit: HRB4188

Midis Bashkisë së Elbasanit
Nr. ____ Prot. Date ____ / ____ / 2026

dhe

Sekretariatit Evropian i ICLEI-t
Nr. ____ Prot. Date ____ / ____ / 2026

ICLEI – Qeveritë Vendore për Qëndrueshmëri është një organizatë globale që përfaqëson dhe mbështet qeveritë vendore në fushën e zhvillimit të qëndrueshëm dhe veprimtimit klimatik, dhe është pjesë e konsorciumit zbatues të programit NetZeroCities, një iniciativë e Bashkimit Evropian për të mbështetur qytetet drejt neutralitetit klimatik.

Neni 1

Palet

Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi është lidhur midis:

1. Bashkia Elbasan, me seli në lagjen 11 Nëntori, Elbasan, Shqipëri, përfaqësuar nga Kryetari i Bashkisë, Z. Gledian Llatja, me NIPT K52905207B,
dhe

2. ICLEI - Qeveritë Vendore për Qëndrueshmëri (përmes Sekretariatit Evropian të ICLEI GmbH) e angazhuar për ndërtimin e një të ardhmeje të qëndrueshme urbane, me NIPT DE153445986, me seli në Leopoldring 3 79098 Freiburg, Gjermani, e përfaqësuar nga znj. Shtilyana Koppe.

Neni 2

Baza Ligjore

Kjo marrëveshje bazohet në:

- Ligji për Vetëqeverisjen Vendore;
- Legjislacioni mbi Organizatat Jo-Fitimprurëse;
- Buxheti i miratuar i Bashkisë për vitin 2026;
- Vendim i Këshillit Bashkiak. Nr. ____, datë ____.
- Karta dhe Rregulloret e ICLEI-Qeveritë Vendore për Qëndrueshmëri

Neni 3

Përshkrimi i partnerit

ICLEI – Qeveritë Vendore për Qëndrueshmëri është një rrjet global i qeverive lokale dhe rajonale, me anëtarësim në mbi 125 vende, që promovon politika dhe zgjidhje të integruara për zhvillim të qëndrueshëm, veprim klimatik, energji të pastër dhe qëndrueshmëri urbane.

ICLEI është pjesë e konsorciumit zbatues të programit NetZeroCities, të financuar nga Horizon Europe, duke ofruar mbështetje teknike, shkëmbim praktikash të mira dhe ndihmë për qytetet në përmbushjen e objektivave të neutralitetit klimatik në kuadër të Misionit të Bashkimit Evropian për Qytetet Neutrale Klimatike dhe Smart. Certifikimi i Bashkisë së Elbasanit në programin NetZeroCity do të na bëjë edhe më shumë lobistë për aplikime përmes ndihmës që ICLEI do të na ofrojë. Brenda kuadrit të këtij programi, Elbasani është certifikuar/përzgjedhur si qytet pjesëmarrës, duke u angazhuar për përmbushjen e objektivave për kalimin drejt neutralitetit klimatik dhe forcimin e kapaciteteve lokale në fushën e politikave klimatike.

Neni 4

Subjekti i Marrëveshjes

Objekti i kësaj marrëveshjeje është bashkëpunimi midis palëve për: Ofrimin e mbështetjes financiare për pagesën e tarifës vjetore të anëtarësimit të Bashkisë në ICLEI – Qeveritë Vendore për Qëndrueshmëri, një rrjet global; Mbështetjen e Bashkisë së Elbasanit në cilësinë e saj si anëtare e plotë e rrjetit ICLEI, në përputhje me shërbimet dhe përfitimet e ofruara për Anëtarët e ICLEI.

Neni 5

Vlera financiare dhe metoda e pagesës

1. Vlera e tarifës vjetore të anëtarësimit është 550 Euro (ose ekuivalenti në lekë 53,008.31, me kursin e këmbimit 1 euro = 96.38 lekë).
2. Pagesa do të bëhet nga Bashkia nëpërmjet transferit bankar në llogarinë e caktuar nga ICLEI, ose sipas marrëveshjes së rënë dakord me OJQ-në.
3. Pagesa bëhet me paraqitjen e dokumentacionit mbështetës (faturë, kërkesë pagese, konfirmim zyrtar).

Neni 6

Detyrimet e Bashkisë

Bashkia merr përsipër të:

1. Siguroni fondin e miratuar për pagesën e tarifës;
2. Të sigurojë dokumentacionin e nevojshëm institucional për regjistrim;
3. Respektoni parimet themelore të ICLEI-t siç paraqiten në Kartën dhe Rregulloren (të dhëna veçmas)
4. Caktoni një pikë kontakti për koordinim me OJQ-në;
5. Mbajeni ICLEI-n të informuar rreth ndryshimeve në informacionin e kontaktit të Bashkisë;

Neni 7

Detyrimet e OJQ-së (ICLEI)

OJQ-ja është e përkushtuar për:

- i) Kryerja e procedurave të aplikimit dhe regjistrimit për Bashkinë e Elbasanit për t'u anëtarësuar në ICLEI – Qeveritë Vendore për Qëndrueshmëri si anëtare me të drejta të plota;
- ii) Mbështetja e Bashkisë së Elbasanit në angazhimin me rrjetin ICLEI, duke përfshirë lehtësimin e aksesit në burimet, mjetet, kërkimet, ngjarjet dhe webinarët përkatës vetëm për anëtarët, si dhe mundësitë për tarifa pjesëmarrjeje të reduktuara ose të hequra, në varësi të disponueshmërisë.
- iii) Informimi i rregullt i Bashkisë së Elbasanit në lidhje me thirrjet e hapura, projektet evropiane, mundësitë e financimit nga BE-ja dhe partneritetet e mundshme brenda rrjetit ICLEI;
- iv) Mbështetja e Bashkisë së Elbasanit në rritjen e dukshmërisë dhe njohjes së veprimeve dhe arritjeve të saj të qëndrueshmërisë përmes kanaleve të komunikimit evropian dhe global, eventeve dhe iniciativave të avokimit të ICLEI-t;
- v) Sigurimi i transparencës duke ofruar informacion mbi zbatimin e kësaj Marrëveshjeje përmes raportimit vjetor të ndikimit të OJQ-së dhe komunikimeve të tjera përkatëse;
- vi) Të lehtësojë mundësitë që Bashkia të angazhohet me kolegët, të marrë pjesë në ngjarjet e ICLEI dhe të kontribuojë në dialogët përkatës të politikave në nivel evropian dhe ndërkombëtar.

Neni 8

Monitorimi dhe raportimi

1. Bashkia ka të drejtë të kërkojë informacione shtesë ose dokumentacion mbështetës.
2. Palët zotohen për transparencë dhe bashkëpunim të ndërsjellë.

Neni 9

Kohezgjatja

Kjo marrëveshje hyn në fuqi në datën e nënshkrimit dhe anëtarësimi bëhet i vlefshëm me pagesën e tarifës së parë vjetore.

Në përputhje me Kartën dhe Rregulloren e ICLEI - Qeveritë Vendore për Qëndrueshmëri, përfundimi i anëtarësimit:

- Mund të kërkohet nga bashkia me shkrim
- Mund të përpunohet nga ICLEI nëse Anëtari nuk e paguan tarifën vjetore për dy vite radhazi

Neni 10

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Mosmarrëveshjet do të zgjidhen fillimisht me marrëveshje të ndërsjellë midis palëve.
Përndryshe, kompetente është Gjykata Administrative e _____.

Neni 11

Dispozita përfundimtare

1. Çdo ndryshim do të bëhet vetëm me marrëveshje me shkrim midis palëve.
2. Marrëveshja hartohet në 4 (katër) kopje, (2 kopje në shqip dhe 2 kopje në anglisht) me vlerë të barabartë ligjore.

PËR BASHKINË

Emri: Kryetari Gledian LLATJA

Nënshkrimi: _____

PËR ICLEI

Emri: **Shtilyana Koppe**
Drejtuese Rajonale për Evropën,
Menaxhimi Organizativ dhe Financat

Nënshkrimi: _____



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
Këshilli Bashkiak

Nr. _____ Prot.

Elbasan, më _____, 2026

PROJEKT- VENDIM

Nr. ____, datë __/__/2026

**“PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES SË BASHKËPUNIMIT PËR
ANËTARËSIMIN E BASHKISË NË PLATFORMËN ‘RRJETI I QEVERISJEVE
VENDORE PËR QËNDRUESHMËRI (ICLEI).”**

Këshilli Bashkiak, në mbledhjen e tij të datës __/__/2026, pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur në mbështetje të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”

VENDOSI :

1. Të miratojë: Në parim marrëveshjen për antarësimin e institucionit në platformën: ‘Rrjeti i Qeverisjeve Vendore për Qëndrueshmëri (ICLEI).’
2. Ngarkohen për zbatim drejtoritë e Bashkisë Elbasan si: Drejtoria e Integritimit Evropian, Projekteve dhe Donatorëve, Drejtoria e Zhvillimit Strategjik dhe Transportit dhe Drejtoria e Buxhet Finances.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas miratimit në Këshillin Bashkiak.

Konceptoi: P.S.P.D

K.Kreka

D.S.F

O.Shehu

P.S 100 qyteteve

A.Hodaj

Pranoi:

D.D.I.E.P.I

E.Çuni

D.D.F.B

P/A.Merkja

D.ZH.S.T

A.Canaj

D.D.J

A.Hoxha

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Elsid Zyma

Kryetar i Këshillit Bashkiak

Lutfi LALA